Hidromorava Gjilan KOMPANIA RAJONALE E UJËSJELLËSIT HIDROMORAVA Sh.a.
No. 1650 Data 22.11.2024
GJILAN

REPUBLIKA E KOSOVES / REPUBLIKA KOSOVA / REPUBLIC OF KOSOVO
QEVERIA - VLADA - GOVERNMENT
MINISTRIA E EKONOMISË
MINISTARSTVO EKONOMIJE
MINISTRY OF ECONOMY
Njesia Org. / Org. Jedin / Org Unit: 01/3
Nr. Prot. / Br. Prot / Prot.No: 7089
Nr. i faqeve / Broj stranica / No. pages: /
Data / Datum / Date: 26-11.24
PRISHTINE/A
NO.1

# KOMPANIA RAJONALE PËR UJËSJELLËS "HIDROMORAVA"- SH.A.

## RAPORTI I PUNËS
## PËR TREMUJORIN E TRETË TË VITIT 2024

Tetor, 2024

# TABELA E PËRMBAJTJES


1. KRYESHEFI EKZEKUTIV ..... 5
   1.1. Hyrje ..... 5
   1.2. Aktivitetet kryesore ..... 5
   1.3. Vendime dhe akte të tjera ..... 7
2. BORDI I DREJTORËVE ..... 10
   2.1. Vendimet e Bordit të Drejtorëve ..... 10
3. KOMISIONI I AUDITIMIT ..... 11
   3.1. Vendimet e Komisionit të Auditimit ..... 11
4. ZYRA E SEKRETARES ..... 12
   4.1. Struktura e të punësuarve ..... 12
   4.2. Çështjet gjyqësore ..... 13
5. ZYRTARJA E LARTË FINANCIARE ..... 15
   5.1. Aktivitetet kryesore ..... 16
   5.2. Shqyrtimi i performances operative dhe financiare ..... 16
6. RAPORTI I ZYRËS SË PROKURIMIT ..... 38
7. RAPORTI PËR CILËSI TË UJIT PËR TM3– 2024 ..... 40
   7.1. Cilësia e ujit ..... 40
8. DIVIZIONI PËR PRODHIMIN, IMPIANTET E UJIT DHE STACIONET E POMPIMIT ..... 43
   8.1. Furnizimi me ujë ..... 42
   8.2. Sasia e ujit të prodhuar, ujit të faturuar dhe humbjeve të ujit ..... 42
   8.3. Mirëmbajta e rrjetit të ujësjellësit ..... 44
   8.4. Mirëmbajta e rrjetit të kanalizimit ..... 49
9. RAPORTI I DIVIZIONIT PËR PLANIFIKIM DHE MENAXHIM TË PROJEKTEVE ..... 50
9.1. Aktivitetet e realizuara gjatë muajit shtator 2024 ..... 50

# TABELAT

Tabela 1. Takimet e Kryeshefit Ekzekutiv me institucionet dhe organizatat relevante gjatë periudhës TM3/2024 ........ 5
Tabela 2. Vendimet e Kryeshefit Ekzekutiv gjatë periudhës TM3/2024 ........ 7
Tabela 3. Numri i të punësuarve në njësitë punuese për periudhën TM3/2024 ........ 12
Tabela 4. Struktura gjinore e të punësuarve për periudhën TM3/2024 ........ 12
Tabela 5. Lëndët e pranuara nga Gjykatat kompetente gjatë periudhës TM3/2024 ........ 13
Tabela 6. Paraqitja grafike e prodhimit të ujit në m³ ........ 16
Tabela 7. Paraqitja grafike e faturimit të ujit në m³ ........ 17
Tabela 8. Paraqitja grafike e faturimit në euro (€) ........ 17
Tabela 9. Paraqitja grafike e arkëtimit të ujit ........ 18
Tabela 10. Paraqitja grafike e përqindjes së arkëtimit ........ 18
Tabela 11. Paraqitja grafike e shpenzimeve në € ........ 19
Tabela 12. Raporti i performancës operative dhe financiare për regjion TM3/2024 dhe TM3/2023 dhe plani TM3/2024 ........ 20
Tabela 13. Raporti i performancës operative dhe financiare për Njësinë Operative të Gjilanit TM3/2024 dhe krahasimi me TM3/2023 ........ 22
Tabela 14. Raporti i performancës operative dhe financiar për Njësinë Operative të Kamenicës TM3/2024 dhe krahasimi me TM3 /2023 ........ 23
Tabela 15. Raporti i performancës operative dhe financiare për Njësinë Operative në Vitisë për TM3/2024, krahasimi me TM3/2023 ........ 24
Tabela 16. Treguesit – të hyrat dhe shpenzimet operative për TM3/2024 dhe krahasimi me TM3/2023 .. 25
Tabela 17. Paraja dhe ekuivalentet e parasë përfshijnë paranë në banka dhe në arkë ........ 32
Tabela 18. Llogaritë e arkëtueshme dhe kërkesat tjera ........ 32
Tabela 19. Stoqet ........ 33
Tabela 20. Pasuritë tjera afatshkurta ........ 33
Tabela 21. Pronat, impiantet dhe pajisjet ........ 33
Tabela 22. Llogaritë e pagueshme ........ 35
Tabela 23. Detyrimet tjera afatshkurtra ........ 35
Tabela 24. Të hyrat e shtyra /grantet ........ 36
Tabela 25. Ekuiteti ........ 36
Tabela 26. Të hyrat ........ 36
Tabela 27. Shpenzimet e shpërndarjes ........ 37
Tabela 28. Shpenzime administrative të tjera TM3 2024 - TM3 2023 ........ 37
Tabela 29. Fitimi (humbja) para tatimit ........ 37
Tabela 30. Ndryshimet në ekutitet ........ 37
Tabela 31. Aktivitetet e zyrës së prokurimit gjatë TM3/2024 – vlerë minimale ........ 38
Tabela 32. Aktivitetet e zyrës së prokurimit gjatë TM3/2024 – kuotim i çmimit ........ 38
Tabela 33. Aktivitetet e prokurimit gjatë TM3/2024 – procedurë e hapur – vlerë e mesme ........ 38
Tabela 34. Aktivitetet e prokurimit gjatë TM3/2024 – procedurë e hapur – vlerë e madhe ........ 39
Tabela 35. Aktivitetet e prokurimit gjatë TM3/2024 – Procedurë e negociuar pa publikim të njoftimit të kontratës- Aneks Kontratë ........ 39

Tabela 36. Sasia e ujit të prodhuar, faturuar dhe ujit të pafaturuar gjatë periudhës së TM3/2024 ............42
Tabela 37. Zona e shërbimit, numri dhe natyra e defekteve të ndodhura gjatë periudhës së TM3/2024....44
Tabela 38. Analiza, prodhimi, faturimi dhe UPF, gjatë periudhës së TM3/2024 në DMA zonat për regjionin e Gjilanit ..........48
Tabela 39. Numri i intervenimeve në rrjetin e kanalizimit gjatë periudhës së TM3/2024..........49
Tabela 40. Mirëmbajtja e rrjetit të kanalizimit gjatë periudhës së TM3/2024 në Gjilan..........49
Tabela 41. Aktivitetet e realizuara nga DPMP gjatë tremujorit të tretë të vitit 2024..........50

## SHËNIMET SHPJEGUESE

Shënimet shpjeguese 1. Paraja dhe ekuivalentet e parasë..........32
Shënimet shpjeguese 2. Llogaritë e arkëtueshme dhe kërkesat tjera ..........32
Shënimet shpjeguese 3. Stoqet..........32
Shënimet shpjeguese 4. Pasuritë tjera afatshkurta ..........33
Shënimet shpjeguese 5. Pasuritë afatgjata – pronat, impiantet dhe pajisjet..........33
Shënimet shpjeguese 6. Investimet në vijim/projektet..........34
Shënimet shpjeguese 7. Llogaritë e pagueshme për TM2 2024..........34
Shënimet shpjeguese 8. Detyrimet tjera afatshkrutra..........35
Shënimet shpjeguese 9. Të hyrat e shtyera/grantet..........36
Shënimet shpjeguese 10. Ndryshimi në ekuitet ..........36
Shënimet shpjeguese 11. Të hyrat..........36
Shënimet shpjeguese 12. Shpenzimet e shpërndarjes ..........37
Shënimet shpjeguese 13. Shpenzimet administrative të tjera ..........37
Shënimet shpjeguese 14. Fitimi (humbja) para tatimit e vitit..........37

# 1. KRYESHEFI EKZEKUTIV

## 1.1. Hyrje

Raporti i përket periudhës raportuese të tremujorit të tretë të vitit 2024 dhe ndërlidhet me performancën aktuale financiare dhe operative, përshkrimin e arritjeve të caqeve të planit të biznesit të KRU "Hidromorava" – Sh.A. Gjilan.

Gjatë kësaj periudhe raportuese, menaxhmenti i Ndërmarrjes është fokusuar në një mbikëqyrje më të madhe në të gjithë sektorët punues, konform aktiviteteve të ushtruara si në: leximin e rregullt të ujëmatësve, efikasitetin e shtuar në mirëmbajtjen e rrjetit të ujësjellësit, sigurimin dhe montimin e ujëmatësve për konsumatorët me paushall, në detektimin e rrjedhjeve, vendosjen e bllokuesve në ujëmatës te konsumatorët që kanë borxhe ndaj Ndërmarrjes, etj.

Sfidë për Ndërmarrjen ende mbeten: inkasimi i borxheve të vjetra, zvogëlimi i humbjeve të ujit përmes identifikimit të kyçjeve ilegale si dhe atyre teknike, evitimi i rrjedhjeve të ujit në kohë sa më të shkurtër etj, për të cilat aktivitete është duke u punuar sipas "Planit te Veprimit për vitin 2024".

## 1.2. Aktivitetet kryesore

Gjatë tremujorit të tretë të vitit 2024, krahas angazhimeve të përditshme në menaxhim të Ndërmarrjes, Kryeshefi Ekzekutiv ka mbajtur edhe takimet e listuara në tabelën më poshtë:

***Tabela 1. Takimet e Kryeshefit Ekzekutiv me institucionet dhe organizatat relevante gjatë periudhës TM3/2024***

| Nr. | Institucioni: | Data: | Qëllimi i takimit: |
|---|---|---|---|
| 1. | EBRD | 01.07.2024 | Takim online me përfaqësuesit e EBRD, ku si temë diskutimi ishte vlerësimi i ofertave për organin mbikëqyrës, ndërtimin e impiantit, si dhe ndërtimin e kolektorëve. |
| 2. | SECO dhe FOPIP | 02.07.2024 | Takim me përfaqësuesit e SECO (Zyra Zvicrane), të cilët kanë kërkuar nga përfaqësuesit e FOPIP, raportim për punën që janë duke e kryer si konsulent të KRU "Hidromorava". |
| 3. | Banka Botrore | 04.07.2024 | Takim pune me përfaqësuesit e Bankës Botërore për projektin FLOWS të fazës së dytë, me ç'rast janë prezantuar dy opsionet e ndërtimit të digës në Kamenicë dhe në bazë të vlerësimit të ekspertëve të angazhuar në këtë projekt, më e përshtatshme është ndërtimi i digës në fshatin Desivojcë. |
| 4. | OSBE | 08.07.2024 | Takim pune me Drejtorin e zyrës regjionale të OSBE - së, ku është diskutuar për rritjen e bashkëpunimit |

| | | | |
|---|---|---|---|
| | | | me Komunën e Ranillugut si dhe furnizimin e rregullt me ujë dhe pagesat e konsumatorëve. |
| 5. | Komuna Kamenicës | 10.07.2024 | Takim pune me Kryetarin e Kamenicës si dhe vizita në terren e punimeve të projektit "Ndërtimi i kyçjeve individuale në fshatrat e Kamenicës". |
| 6. | SHUKOS | 11.07.2024 | Takim i rregullt i Bordit SHUKOS. |
| 7. | Ministria e Ekonomisë | 22.07.2024 | Takim pune në Ministrinë e Ekonomisë, ku është diskutuar për mundësinë e rritjes së bashkëpunimit me Postën e Kosovës, si dhe KRU-të ta shohin mundësinë e zarfimit të faturave përmes Postës së Kosovës. |
| 8. | Komuna Gjilan | 24.07.2024 | Takim pune me Kryetarin e Komunës së Gjilanit, ku është diskutuar për mundësinë që projekti FLOWS të filloj sa më shpejt me punimet dhe t'i jepet prioritet gypit i cili kalon në rrugën "Hamdi Kurteshi" pasi që Komuna ka filluar punimet në këtë rrugë. |
| 9. | SHUKOS | 25.07.2024 | Takim pune në SHUKOS, me ç'rast janë diskutuar dy pika kryesore: raportimi financiar për gjashtë mujorin e parë si dhe përgatitjet për organizimin e konferencës së ujërave që do të mbahet në javën e parë të nëntorit. |
| 10. | Komuna Kamenicë | 23.08.2024 | Takim pune me Kryetarin e Kamenicës, vizitë në terren për të monitoruar fazën në të cilën gjenden punimet në ndërtimin e rrjetit të ujësjellësit në fshatin Berivojcë. |
| 11. | Komuna Gjilan | 26.08.2024 | Takim pune me Kryetarin e Gjilanit, vizitë në teren për të monitoruar fazën në të cilën gjenden punimet në ndërtimin e rrjetit të ujësjellësit në fshatin Cërnicë. |
| 12. | EBRD | 28.08.2024 | Takim pune online me përfaqësuesit e EBRD - së, për t'i diskutuar sfidat me të cilat është duke u përballur projekti për ITUZ Gjilan, siç janë buxheti i vogël për shkak se është ndarë në vitin 2018 si dhe sfidë tjetër është edhe TVSH për kredinë 11,000,000.00€ nga EIB. |
| 13. | Komuna Gjilan | 05.09.2024 | Takim pune me Kryetarin e Komunës së Gjilanit, vizitë në terren për të monitoruar fazën në të cilën gjenden punimet në ndërtimin e rrjetit të ujësjellësit në fshatin Cërnicë, si dhe diskutim për projektet tjera në interes të përbashkët. |
| 14. | EBRD dhe Konsulenti i jashtëm për ITUZ | 05.09.2024 | Takim pune me përfaqësuesit e EBRD – së dhe konsulentin e jashtëm për ITUZ, për t'i diskutuar |

| | | | |
|---|---|---|---|
| | | | sfidat me të cilat është duke u përballur projekti për ITUZ Gjilan, siç është buxheti jo i mjaftueshëm ku si pasojë nuk mund të vazhdojmë me nënshkrimin e kontratave. |
| 15. | OSBE | 09.09.2024 | Takim pune me përfaqësues të OSBE - së, ku si temë diskutimi ishte furnizimi i rregullt me ujë, rritja e kapaciteteve të ujit, si dhe inkasimi në fshatrat e Komunës së Ranillugut. |
| 16. | Ministria e Financave dhe EBRD | 13.09.2024 | Takim pune me Ministrin e Financave dhe Drejtorin e EBRD, ku si temë diskutimi kanë qenë sfidat e të gjitha KRU-ve që kanë projekte përmes EBRD. |
| 17. | Komuna Gjilan | 17.09.2024 | Takim pune me Kryetarin e Komunës së Gjilanit, ku si temë diskutimi ka qenë përgatitja e disa projekteve infrastrukturore të cilat Komuna Gjilan mund t'i financojë përmes fondeve të marra nga Qeveria për vitet 2025 dhe 2026. |
| 18. | SHUKOS | 23 dhe 24.09.2024 | Punëtori e organizuar nga SHUKOS, ku pjesëmarrës kanë qenë të gjitha KRU-të si dhe ARRU, ku është diskutuar në lidhje me vizionin e SHUKOS në të ardhmën pas vitit 2025. |

## 1.3. Vendime dhe akte të tjera

Në kudër të detyrave dhe përgjegjësive të tij, Kryeshefi Ekzekutiv gjatë tremujorit të tretë të vitit 2024 ka nxjerrë 19 vendime të listuara si më poshtë:

***Tabela 2. Vendimet e Kryeshefit Ekzekutiv gjatë periudhës TM3/2024***

| Nr. | Vendimi: | Numri i Vendimit: | Data e protokollimit: |
|---|---|---|---|
| 1. | Vendim për ndërprerjen e marrëdhënies së punës sipas fuqisë ligjore – pensionimi, për të punësuarin Ismet Maliqi, i sistemuar në punët dhe detyrat punuese "Rojtar" tek Guri i Hoxhës në Përlepnicë. | 764 | 01.07.2024 |
| 2. | Vendim për publikimin e konkursit publik për vendin e lirë të punës një /1/ inxhinier për planifikim dhe zhvillim në KRU "Hidromorava"- Sh.A. | 777 | 03.07.2024 |
| 3. | Vendim për formimin e komisionit lidhur me vlerësimin e shprehjeve të interesit për mbikqyrjen e pakos një (1) të | 806 | 08.07.2024 |

| | | | |
|---|---|---|---|
| | punimeve për pjesëmarrjen e komisionit në procesin e vlerësimit të projektit FLLOWS. | | |
| 4. | Vendim për sistemimin e të punësuarit z. Amir Rexha në punët dhe detyrat punuese "Menaxher i divizionit për planifikim dhe zhvillim të projekteve" në KRU "Hidromorava"- Sh.A. | 844 | 18.07.2024 |
| 5. | Vendimin për caktimin e komisionit lidhur me ecurinë e procedurës rekrutuese për pozitën Inxhinier për Planifikim dhe Zhvillim në KRU "Hidromorava"- Sh.A, konform konkursit publik nr. 778 të datës: 03.07.2024 | 864 | 24.07.2024 |
| 6. | Vendimin për caktimin e komisionit lidhur me shqyrtimin e ankesave të aplikuesve për pozitën Inxhinier për Planifikim dhe Zhvillim në KRU "Hidromorava" Sh.A. sipas Konkursit Publim nr.778 të datës: 03.07.2024. | 865 | 24.07.2024 |
| 7. | Vendim për caktimin e komisionit lidhur me ecurinë e procedurës rekrutuese për pozitën Zyrtar për Burime Njerëzore në KRU "Hidromorava" Sh.A, sipas Konkursit Publik Nr.919 të datës: 05.08.2024. | 1009 | 22.08.2024 |
| 8. | Vendim për caktimin e komisionit lidhur me shqyrtimin e ankesave të kandidatëve për pozitën Zyrtar për Burime Njerëzore në KRU "Hidromorava" Sh.A, sipas Konkursit Publik Nr. 919 të datës: 05.08.2024. | 1010 | 22.08.2024 |
| 9. | Vendim për lejimin e dhënies së ndihmës materiale punëtorit Bleron Haliti në shumë prej 150.00 €, me rastin e vdekjes së anëtarit të ngushtë të familjes (babait), konform Rregullores për kompenzimin e udhëtimit zyrtar, gradimeve dhe ndihmave solidare. | 1011 | 22.08.2024 |
| 10. | Vendim që i punësuari Nexhmedin Miftari, i sistemuar në punët dhe detyrat punuese "Lexues i Ujëmatësve" të sistemohet në punët dhe detyrat punuese "Operator në FPU Velekincë", duke u mbështetur në nenin 17. pikën 2 të Ligjit të Punës dhe nenit 18. pika 1. të Rregullores për krijimin e mardhënies së punës të KRU "Hidromorava"- SH.A. | 1026 | 28.08.2024 |
| 11. | Vendim që i punësuari Xhevat Rashiti, i sistemuar në punët dhe detyrat punuese "Punëtor fizik në mirëmbajtjen e rrjetit të ujësjellësit", të sistemtohet në punët dhe detyrat punuese "Punëtor fizik në mirëmbajtje të rrjetit të kanalizimit në KRU "Hidromorava" Sh.A., duke u mbështetur në nenin 17. pika 2 të Ligjit të Punës dhe nenit 18. pika 1. të Rregullores për krijimin e mardhënies së punës të KRU "Hidromorava" Sh.A. | 1028 | 28.08.2024 |

| | | | |
|---|---|---|---|
| 12. | Vendim që i punësuari Murat Suli, i sistemuar ne punët dhe detyrat punuese "Punëtor fizik në mirëmbajtjen e rrjetit të kanalizimit", të sistemohet në punët dhe detyrat punuese "Punëtor fizik në mirëmbajtje të rrjetit të ujësjellësit në KRU "Hidromorava" Sh.A. duke u mbështetur në nenin 17. pika 2 të Ligjit të Punës dhe nenit 18. pika 1. të Rregullores për krijimin e mardhënies së punës të KRU "Hidromorava"-SH.A, është sistemuar | 1030 | 28.08.2024 |
| 13. | Vendim për lejimin e pushimit pa pagesë për të punësuarën Bukurije Thaçi, e sistemuar në punët dhe detyrat punuese "Zyrtare e kyçjeve në KRU "Hidromorava" Sh.A.", duke filluar nga data: 12.08.2024 deri më datë: 31.12.2024, për arsye familiare, duke u mbështetur në nenin 40. paragrafi 1. të Ligjit të Punës Nr.03/L-212. | 1032 | 28.08.2024 |
| 14. | Vendim për lejimin e pushimit pa pagesë në kohëzgjatje prej tre (3) muajve për të punësuarin Ardian Spahiu – Punëtor fizik në Nj.O. në Kamenicë, konform nenit 40. paragrafi 1. të Ligjit të Punës Nr.03/L-212. | 1097 | 12.09.2024 |
| 15. | Vendim për caktimin e komisionit për pranimin teknik të punimeve "Rregullimi i rrethojes tek Guri i Hoxhës në fshatin Përlepnicë". | 1119 | 18.09.2024 |
| 16. | Vendim për shfuqizimin e vendimit lidhur me shpërblimin e rasteve të zbuluara të identifikimit të kyçjeve ilegale. | 1465 | 27.09.2024 |
| 17. | Vendim për ndërprerjen e marrëdhënies së punës për të punësuarën Nazmije Demiri – Zyrtare në shërbimin e kontabilitetit, konform nenit 67.pika 1.4, nenit 72. të Ligjit të Punës në Kosovë Nr.03/L-212, dhe nenit 8. pika 5. të kontratës së punës nr. 111/1 të dt. 31.01.2023, pasi që e njëjta ka mbushur moshën e pensionit. | 1467 | 30.09.2024 |

## 2. BORDI I DREJTORËVE

Bordi i Drejtorëve të KRU "Hidromorava" gjatë tremujorit të tretë të vitit 2024 ka mbajtur dy /2/ mbledhje të rregullta.

### 2.1.Vendimet e Bordit të Drejtorëve

Vendimmarrja në Bordin e Drejtorëve gjithmonë është bërë në mënyrë të lirë dhe demokratike duke e respektuar të drejtën e votimit të lirë, pa presion dhe vendosjes me shumicën e votave të anëtarëve të Bordit.

Bordi i Drejtorëve në tremujorin e tretë të vitit 2024, bazuar në procesverbalet e datave: 30.07.2024, 27.08.2024, ka marrë këto vendime:

- Bordi i Drejtorëve, në mbledhjet e mbajtura në muajin korrik dhe gusht ka miratuar Raportet mujore të Punës për muajin qershor dhe korrik 2024;
- Bordi i Drejtorëve, në mbledhjen e mbajtur më: 30.07.2024 ka miratuar "Rishikimin e Planit të Biznesit për vitin 2024" me plotësim ndryshimet e kërkuara;
- Bordi i Drejtorëve, në mbledhjen e mbajtur më: 30.07.2024 ka miratuar "Rregulloren për përdorimin e automjeteve zyrtare të KRU Hidromorava Sh.A.";
- Bordi i Drejtorëve, në mbledhjen e mbajtur më: 27.08.2024 ka miratuar unanimisht "Raportin e tremujorit të dytë të vitit 2024" të KRU "Hidromorava" Sh.A.

# 3. KOMISIONI I AUDITIMIT

Komisioni i Auditimit gjatë tremujorit të tretë të vitit 2024 ka mbajtur një /2/ mbledhje të rregullta dhe bazuar në procesverbalet e datave: 05.08.2024 dhe 05.09.2024, ka marrë këto vendime:

## 3.1. Vendimet e Komisionit të Auditimit

- Komisioni i Auditimit, në mbledhjën e gjashtë të rregullt të mbajtur më datë: 05.08.2024 unanimisht ka miratuar Rishpalljen e Konkursit Publik për Zyrtarin e Auditimit të Brendshëm;
- Komisioni i Auditimit, në mbledhjën e shtatë të rregullt të mbajtur më datë: 05.09.2024 unanimisht ka miratuar Raportin e auditimit "Kyçjet individuale për fshatrat Muçivërcë, Dajkoc, Hodonoc, Novosellë, Shipashnicë e Ulët, Roganë – Komuna e Kamenicës - Situata e parë e përkohëshme e punëve të kryera";
- Komisioni i Auditimit, në mbledhjën e shtatë të rregullt të mbajtur më datë: 05.09.2024 unanimisht miratoi anulimin e Konkursit Publik (rishpallja e konkursit publik) për pozitën e Zyrtarit të Auditimit të Brendshëm i datës: 07.08.2024, për shkak të mos plotësimit të kritereve sipas konkursit nga asnjëri prej kandidatëve.

# 4. ZYRA E SEKRETARES

Gjatë tremujorit të tretë të vitit 2024, janë protokolluar dhe arkivuar 430 akte nga shërbimi juridik. Gjatë këtij tremujori janë mbajtur gjithsej dhjetë /10/ mbledhje të rregullta të Menaxhmentit të Ndërmarrjes. Gjithashtu, janë nxjerrë akte si: urdhëresa, lajmërime, njoftime, vërtetime të ndryshme konsumatorëve dhe punëtorëve të Ndërmarrjes për nevoja personale, vendime për pushime vjetore, autorizime, kërkesa, përgjigje në kërkesa dhe ankesa të ndryshme. Janë inicuar shtatë /7/ kallëzime penale ndaj konsumatorëve të pandërgjegjshëm dhe janë pranuar 15 ankesa me shkrim lidhur me pakënaqësitë e konsumatorëve lidhur me borxhin e faturuar, me ç'rast Komisioni për shqyrtimin e ankesave i ka shqyrtuar të gjitha.

## 4.1. Struktura e të punësuarve

KRU "Hidromorava" Sh.A Gjilan, ka operuar me gjithsej 165 të punësuar.

*Tabela 3. Numri i të punësuarve në njësitë punuese për periudhën TM3/2024*

| Numri i të punësuarve në njësitë e caktuara punuese | Gjilan | Kamenicë | Viti |
|---|---|---|---|
| | 128[1] | 17 | 20 |

*Tabela 4. Struktura gjinore e të punësuarve për periudhën TM3/2024*

| Numri i të punësuarve sipas përkatësisë gjinore | Numri i të punësuarve (meshkuj) | Numri i të punësuarave (femra) | Numri total i të punësuarve |
|---|---|---|---|
| | 140 | 25 | 165 |

[1] Arsyeja e dallimit të numrit të të punësuarve në Gjilan nga periudha e TM2 2024 është pasiqë i punësuari Kreshnik Aliu është caktuar nga Nj.O. në Viti në Nj.O. në Gjilan dhe i punësuari Zymer Mustafa është caktuar nga Nj.O. në Kamenicë në Nj.O. në Gjilan.

## 4.2. Çështjet gjyqësore

Gjatë tremujorit të tretë të vitit 2024, KRU "Hidromorava"- SH.A. në Gjilan, nga ana e gjykatave kompetente ka pranuar lëndët e paraqitura në tabelën e mëposhtme.

*Tabela 5. Lëndët e pranuara nga Gjykatat kompetente gjatë periudhës TM3/2024*

| Lëndët e pranuara nga gjykatat kompetente | | | |
|---|---|---|---|
| **Datë** | **Institucioni** | **Nr. Aktvendimit** | **Arsyetimi** |
| 03.07.2024 | Gjykata Themelore në Gjilan | P.nr.167/24 të dt.24.06.2024 | Me Aktgjykimin e Gjykatës Themelore në Gjilan, P.nr. 167/2024 i dt. 24.06.2024, i pandehuri Remzi Limani nga fshati Uglar, Komuna Gjilan, është shpallur fajtor për veprën penale "vjedhje e shërbimeve nga neni 314. parag.6 lidhur me paragrafin 1. të KPRK-së". |
| 03.07.2024 | Gjykata Themelore në Gjilan – Departamenti i Përgjithshëm | P.nr.268/24 i dt.28.06.2024 | Me Aktgjykimin e Gjykatës Themelore në Gjilan, P.nr. 268/24 i dt. 28.06.2024, i pandehuri Elbasan Hyseni nga f. Zhegër, Komuna Gjilan, është shpallur fajtor për veprën penale "vjedhje e shërbimeve nga neni 314. parag.6 lidhur me paragrafin 1. të KPRK-së". |
| 05.07.2024 | Gjykata e Apelit e Kosovës | PAI.nr.512/24 i dt. 03.06.2024 | Me Aktgjykimin e Gjykatës së Apelit të Kosovës është refuzuar si e pa bazuar ankesa e mbrojtësit të të akuzuarit Shkelzen Gashi për shkak të veprës penale Vjedhje e rëndë në tentativë nga neni 315 parag.1, nënparag. 1.1. lidhur me nenin 28 të KPRK-së. |
| 17.07.2024 | Gjykata e Apelit e Kosovës, Prishtinë | AC.nr.7508/2021 i dt. 13.06.2024 | Me aktvendimin e Gjykatës së Apelit të Kosovës, është refuzuar si e pa themeltë ankesa e të autorizuarit të paditësit Xhemajl Ramizi nga Gjilani, ndërsa aktvendimi i Gjykatës së Apelit të Kosovës në Prishtinë, CN nr.75/20 i dt.28.06.2020, vërtetohet për shkak të pasurimit pa bazë dhe mashtrim. |
| 17.07.2024 | Gjykata Themelore në Gjilan-Departamenti i Përgjithshëm | P.nr.245/2024 i dt. 04.07.2024 | Me Aktgjykimin e Gjykatës Themelore në Gjilan, P.nr. 245/24 i dt. 04.07.2024, e pandehura Gyner Hajrullahu nga Gjilani, është shpallur fajtore për veprën penale "vjedhje e shërbimeve nga neni 314. parag.6 lidhur me paragrafin 1. të KPRK-së". |
| 17.07.2024 | Gjykata Komerciale e Kosovës – Dhoma e Shkallës së Dytë | K.DH.SH.II.nr.467/24 i dt.22.05.2024 | Është refuzuar si e pathemeltë ankesa e debitorit Kryqi i Kuq me seli në Kamenicë, ndërsa aktvendimi i Gjykatës Komerciale- Dhoma e shkallës së parë - departamenti i përgjithshëm nr.1141/22 të dt. 16.11.2023, vërtetohet për shkak të borxhit prej 2,714.77€. |

| | | | |
|---|---|---|---|
| 12.08.2024 | Gjykata Themelore në Gjilan – Departamenti i Përgjithshëm | C.nr.1525/2023 i dt. 08.07.2024 | Me Aktgjykimin e Gjykatës Themelore në Gjilan, C.nr. 1525/2023 të dt. 08.07.2024, është refuzuar në tërësi si e pabazuar padia dhe kërkesëpadia e paditësit Mumin Morina nga Gjilani, për shkak anulimit të vendimit për ndërprerjen e mardhënies së punës dhe kompensimin e të ardhurave personale. |
| 22.08.2024 | Gjykata Themelore në Gjilan – Departamenti i Përgjithshëm | CPK.nr. 57/2023 i dt. 29.07.2024 | Me aktvendimin e Gjykatës Themelore në Gjilan, CPK. nr.57/2023 të dt. 29.07.2024, është hedhur poshtë ankesa e debitorit Blerim Kajtazi nga Gjilani, e parashtruar kundër aktvendimit të kësaj gjykate, CPK.nr.57/23 të dt. 01.08.2023, për shkak borxhit në shumë prej 1,476.01€. |
| 22.08.2024 | Gjykata Themelore në Gjilan – Departamenti i Përgjithshëm | CPK.nr. 15/2024 i dt. 02.08.2024 | Është refuzuar si i pa bazuar prapësimi i debitorit Bejtush Ajvazi nga Gjilani, ndërsa mbetet në fuqi urdhëri përmbarimor P.nr. 662/18 i dt. 21.11.2018 , për shkak borxhit të debitorit në vlerë prej: 1,577.05€. |
| 22.08.2024 | Gjykata Themelore në Gjilan – Departamenti i Përgjithshëm | P.nr.700/2023 i dt. 14.08.2024 | Me Aktgjykimin e Gjykatës Themelore në Gjilan, P.nr. 700/2023 i dt. 14.08.2024, i pandehuri Selver Zymeri nga Gjilani, është shpallur fajtor për veprën penale "vjedhje e shërbimeve nga neni 314. parag.6 lidhur me paragrafin 1. të KPRK – së". |
| 28.08.2024 | Gjykata Themelore në Gjilan – Dega Kamenicë | PPP.nr. 19/21 i dt. 20.08.2024 | Me aktvendimin e Gjykatës Themelore në Gjilan, Dega në Kamenicë, PPP. nr.19/2021 të dt. 20.08.2024, është aprovuar pjesërisht prapësimi i debitorit Fatmir Berisha nga Kamenica, me të cilën nga borxhi total në vlerë prej: 1,262.69€, të njejtit i është parashkruar borxhi në vlerë prej: 1,197.85€, ndërsa borxhi për pagesë ndaj kreditorit mbetet në vlerë prej: 54,84€, kundër këtij aktvendimi kreditori ka parashtruar ankesë në Gjykatën e Apelit në Prishtinë. |
| 28.08.2024 | Gjykata Themelore në Gjilan – Dega në Kamenicë | PPP. nr. 28/21 i dt. 20.08.2024 | Me aktvendimin e Gjykatës Themelore në Gjilan, Dega në Kamenicë, PPP. nr.28/2021 të dt. 20.08.2024, është aprovuar pjesërisht prapësimi i debitorit Xhela Ahmeti nga Kamenica, me të cilën nga borxhi total në vlerë prej: 1,342.63€, të njejtit i është parashkruar borxhi në vlerë prej: 1,290.00€, ndërsa borxhi për pagesë ndaj kreditorit mbetet në vlerë prej: 52,63€, kundër këtij aktvendimi kreditori ka parashtruar ankesë në Gjykatën e Apelit në Prishtinë. |

| | | | |
|---|---|---|---|
| 29.08.2024 | Gjykata Themelore në Gjilan – Departamenti i Përgjithshëm | P.nr.478/2024 i dt. 20.08.2024 | Me Aktgjykimin e Gjykatës Themelore në Gjilan, P.nr. 478/2024 i dt. 20.08.2024, i pandehuri Servet Mehmeti nga Gjilani, është shpallur fajtor për veprën penale "vjedhje e shërbimeve nga neni 314. parag.6 lidhur me paragrafin 1. të KPRK-së". |
| 11.09.2024 | Gjykata e Themelore në Gjilan – Departamenti i Përgjithshëm | P.nr.396/2024 i dt.04.09.2024 | Me Aktgjykimin e Gjykatës Themelore në Gjilan, P.nr. 396/2024 i dt. 04.09.2024, i pandehuri Fatmir Cakolli nga fshati Kmetoc, Gjilan, është shpallur fajtor për veprën penale "vjedhje e shërbimeve nga neni 314. parag.6 lidhur me paragrafin 1. të KPRK-së". |
| 11.09.2024 | Gjykata Themelore në Gjilan – Departamenti i Përgjithshëm | P.nr.532/2019 i dt.06.09.2024 | Me aktvendimin e Gjykatës Themelore në Gjilan, P.nr. 532/2019 i dt.06.09.2024, refuzohet si i pa bazuar prapësimi i dt.17.12.2019 i debitorit Isa Shurdhani nga Gjilani, ndërsa urdhëri përmbarimor P.nr.532/2019 i datës 06.12.2019 mbetet në fuqi, për shkak borxhit prej 1,026.17€. |
| 23.09.2024 | Dhoma e Posaçme e Gjykatës Supreme të Kosovës – Kolegji i Apelit | AC-I-24-0425 i dt.19.09.2024 | Me Aktgjykimin e DHPGJS-së AC-I-24-0425 e dt.19.09.2024, Kolegji i Apelit ka vërtetuar Aktgjykimin e shkallës së parë të DHPGJS-së, C-IV-14-0521 i datës 16.05.2024, duke ia njohur të drejtën kreditorit KRU "Hidromorava" – Sh.A, për shkak borxhit 11,064.62€, ndaj debitorit NSH I.M.B "Kualiteti" (në likuidim). |

# 5. ZYRTARJA E LARTË FINANCIARE

## 5.1. Aktivitetet kryesore

Gjatë tremujorit të tretë të vitit 2024, nga Divizioni Financiar janë janë realizuar aktivitetet:

- kontrollimi dhe barazimi i llogarive të pagueshme dhe llogarive të arkëtueshme;
- raportet ditore nga shërbimi i arkave;
- barazimi i gjendjeve bankare;
- kontimet;
- shkarkimet nga pagesat të cilat transferohen nga insitucionet mikrofinanciare dhe bankare;
- kontrollimi dhe pranimi i faturave për blerjet si dhe regjistrimi i tyre;
- përgatitjet e pagave;
- plotësimi i librave të blerjes dhe shitjes sipas formës së kërkuar nga ATK-ja për muajin përkatës dhe tremujore,
- deklarimi i tatimeve, TVSH-së, tatimet e pagave sipas ligjit në fuqi.

## 5.2. Shqyrtimi i performances operative dhe financiare

### 5.2.1. Prodhimi i ujit në $m^3$

Prodhimi i ujit në $m^3$ për TM3/2024 në krahasim me TM3/2023 ka rritje për 6.27 %, ndërsa sa i përket arritjes së cakut të planifikuar është tejkaluar për 10.58 %.

*Tabela 6. Paraqitja grafike e prodhimit të ujit në $m^3$*



### 5.2.2. Faturimi i ujit në m³

Faturimi i ujit në m³ për TM3/ 2024 në krahasim me TM3/2023 ka shënuar rritje për 6.30 %, ndërsa sa i përket cakut të planfikuar, është nën plan për 10.29 %.

*Tabela 7. Paraqitja grafike e faturimit të ujit në m³*




### 5.2.3. Faturimi i ujit në euro (€)

Faturimi i ujit në euro (€) në TM3/2024 në krahasim me TM3/2023 ka rritje 7.17 %, ndërsa sa i përket cakut të planifikuar, është nën plan për 8.63 %.

*Tabela 8. Paraqitja grafike e faturimit në euro (€)*



#### 5.2.4. Arkëtimi i ujit/€

Arkëtimi i ujit për TM3/2024 në krahasim me TM3/2023 ka shënuar rritje për 6.58 %. Arkëtimi i e borxheve të vjetra ka ndikuar në rritje të normës së arkëtimit, ndërsa sa i përket realizimit të planit, është tejkaluar për 9.88 %.

*Tabela 9. Paraqitja grafike e arkëtimit të ujit/€*




##### 5.2.4.1. Përqindja e arkëtimit

Përqindja e arkëtimit nga faturimi për TM3/2024 në krahasim me TM3/2023 ka shënuar rritje simbolike për 0.56 %, ndërsa plani është tejkaluar për 20.26 %.

*Tabela 10. Paraqitja grafike e përqindjes së arkëtimit*



### 5.2.5. Shpenzimet operative

Shpenzimet në TM3/2024 në krahasim me TM3/2023, kanë shënuar rritje për 0.58 %. Ndërsa sa i përket shpenzimeve të parashikuara janë për 4.86 % më të ulëta nga planifikimi.

*Tabela 11. Paraqitja grafike e shpenzimeve në €*



*Tabela 12. Raporti i performancës operative dhe financiare për regjion TM3/2024 dhe TM3/2023 dhe plani TM3/2024*

| | Indikatorët – Regjion | TM3 /2024 | TM3 /2023 | Realizimi 2024/2023 (në %) | Trendi 2024/2023 | Plani TM3 /2024 | Realizimi i planit (në %) | Trendi 2024 në raport me planin |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| 1. | Prodhimi i ujit ($m^3$) | 2,543,372 | 2,393,320 | 106.27 | poz | 2,300,000 | 110.58 | poz |
| 2. | Faturimi ($m^3$) | 1,305,306 | 1,227,986 | 106.30 | poz | 1,455,022 | 89.71 | neg |
| 3. | Uji i pafaturar ($m^3$) | 1,238,066 | 1,165,334 | 106.24 | neg | 844,978 | 68.25 | neg |
| 4. | Faturimi (€) | 733,789[2] | 684,372 | 107.17 | poz | 803,066 | 91.37 | neg |
| 5. | Arkëtimi (€) | 825,252 | 774,287 | 106.58 | poz | 751,336 | 109.88 | poz |
| 6. | Shkalla e arkëtimit (%)[3] | 112.46 | 113.09 | 99.45 | neg | 93.56 | 120.26 | poz |
| 7. | Shpenzimet operative (€)[4] | 526,640 | 523,592 | 100.58 | neg | 553,520 | 105.10 | poz |
| 8. | Numri i konsumtorëve të regjistruar (total) | 43,017 | 41,103 | 104.66 | poz | 42,183 | 101.98 | poz |
| 9. | Numri i konsumatorëve me ujëmatës (nr) | 38,983 | 37,181 | 104.85 | poz | 39,030 | 99.88 | neg |
| 10. | Numri i konumatorëve me konsum zero (nr) | 18,440 | 17,189 | 107.28 | neg | 13,780 | 74.73 | neg |
| 11. | Konsumatorë të rinj (nr) | 350 | 610 | 57.38 | neg | 120 | 291.67 | poz |
| 12. | Numri i konsumatorëve aktiv (nr) | 39,141 | 37,389 | 104.69 | poz | 39,085 | 100.14 | poz |
| 13. | Numri i konsumatorëve pa matje (nr) | 158 | 208 | 75.96 | poz | 30 | 18.99 | neg |
| 14. | Faturimi i ujit me ujëmatës ($m^3$) | 1,271,815 | 1,225,797 | 103.75 | poz | 1,452,985 | 87.53 | neg |
| 15. | Proporcioni i konsumatorë me ujëmatës (%) | 99.60 | 99.44 | 100.16 | poz | 99.86 | 99.74 | neg |
| 16. | UPF në (%) | 48.68 | 48.69 | 99.98 | poz | 36.74 | 75.47 | neg |

[2] Është plotësuar edhe me faturimin nga shërbimet (plotësim sipas kërkesave nga KA-së).

[3] Ka ndryshim të përqindjes së arkëtimit pas korrigjimit në faturim.

[4] Rritja e shpenzimeve të pagave gjatë tremujorit të tretë të vitit 2024 krahasuar me të njëjtën periudhë është rezultat i rritjes së stafit në Nj.O Viti, në vlerë prej 6,292 €. Shpenzimt e energjisë elektrike kanë shënuar rritje në vlerë prej 1,896 € në Nj.O në Viti, 1,871 € në Nj.O Kamenicë. Zvogëlim të shpenzimeve kemi në Nj.O Gjilan si rezultat nga ulja e shpenzimeve të derivateve, IKSHP-së, mirëmbajtjes së rrjetit të ujësjellsit dhe shpenzimeve të provizioneve nga MIF për pagesa të faturave.

| | | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| 17. | Norma e mbulimit operativ | 1.39 | 1.31 | 106.55 | poz | 1.45 | 96.09 | neg |
| 18. | [5]Fitimi/humbja operative | 207,149 | 161,080 | 128.60 | poz | 249,546 | 83.01 | neg |
| 19. | Kostoja për Njësi (€/m³) | 0.21 | 0.22 | 94.65 | poz | 0.24 | 116.23 | poz |
| 20. | Efikasiteti i stafit ('000 kons) | 4.22 | 4.33 | 97.29 | poz | 4.35 | 103.18 | poz |

[5] Ftitimi operativ para shpenzimeve të zhvlerësimit dhe borxhit të keq (plotësim sipas kërkesave të KA-së).

*Tabela 13. Raporti i performancës operative dhe financiare për Njësinë Operative të Gjilanit TM3/2024 dhe krahasimi me TM3/2023*

| | Indikatorët – Gjilan | TM3 /2024 | TM3 /2023 | Realizimi 2024/2023 (në %) | Trendi 2024/2023 |
|---|---|---|---|---|---|
| 1. | Prodhimi i ujit ($m^3$) | 1,838,013 | 1,814,272 | 101.31 | poz |
| 2. | Faturimi ($m^3$) | 1,031,462 | 995,411 | 103.62 | poz |
| 3. | Uji i pafaturar ($m^3$) | 806,551 | 818,861 | 98.50 | poz |
| 4. | Faturimi (€) | 589,503 | 559,044 | 105.45 | poz |
| 5. | Arkëtimi (€) | 685,912 | 644,975 | 106.35 | poz |
| 6. | Shkalla e arkëtimit (%) | 116.35 | 115.37 | 100.85 | poz |
| 7. | Shpenzimet (€) | 399,380 | 404,173 | 98.81 | poz |
| 8. | Numri i konsumtorëve të regjistruar (total) | 32,817 | 31,480 | 104.25 | poz |
| 9. | Numri i konsumatorëve me ujëmatës (nr) | 30,543 | 29,310 | 104.21 | poz |
| 10. | Numri i konumatorëve me konsum zero (nr) | 13,969 | 13,196 | 105.86 | neg |
| 11. | Konsumatorë të rinj (nr) | 179 | 353 | 50.71 | neg |
| 12. | Numri i konsumatorëve aktiv (nr) | 30,603 | 29,424 | 104.01 | poz |
| 13. | Numri i konsumatorëve pa matje (nr) | 60 | 114 | 52.63 | poz |
| 14. | Faturimi i ujit me ujëmatës ($m^3$) | 1,020,687 | 994,877 | 102.59 | poz |
| 15. | Proporcioni i konsumatorë me ujëmatës (%) | 99.80 | 99.61 | 100.19 | poz |
| 16. | UPF në (%) | 43.88 | 45.13 | 97.23 | poz |
| 17. | Norma e mbulimit operativ | 1.48 | 1.38 | 106.71 | poz |
| 18. | Fitimi/humbja operative | 190,123 | 154,871 | 122.76 | poz |
| 19. | Kostoja për njësi (€/$m^3$) | 0.22 | 0.22 | 100.00 | poz |
| 20. | Efikasiteti i stafit ('000 kons) | 4.18 | 4.35 | 96.15 | poz |

*Tabela 14. Raporti i performancës operative dhe financiar për Njësinë Operative të Kamenicës TM3/2024 dhe krahasimi me TM3 /2023*

| | Indikatorët – Kamenicë | TM3/2024 | TM3/2023 | Realizimi 2024/2023 (në %) | Trendi 2024/2023 |
|---|---|---|---|---|---|
| 1. | Prodhimi i ujit (m$^3$) | 256,719 | 250,808 | 102.36 | poz |
| 2. | Faturimi (m$^3$) | 136,795 | 136,734 | 100.04 | poz |
| 3. | Uji i pafaturar (m$^3$) | 119,924 | 114,074 | 105.13 | neg |
| 4. | Faturimi (€) | 70,000 | 70,544 | 99.23 | neg |
| 5. | Arkëtimi (€) | 80,611 | 72,096 | 111.81 | poz |
| 6. | Shkalla e arkëtimit (%) | 115.16 | 102.20 | 112.68 | poz |
| 7. | Shpenzimet (€) | 68,531 | 65,976 | 103.87 | neg |
| 8. | Numri i konsumtorëve të regjistruar (total) | 5,403 | 5,345 | 101.09 | poz |
| 9. | Numri i konsumatorëve me ujëmatës (nr) | 4,290 | 4,252 | 100.89 | poz |
| 10. | Numri i konumatorëve me konsum zero (nr) | 2,066 | 2,077 | 99.47 | poz |
| 11. | Konsumatorë të rinj (nr) | 32 | 50 | 64.00 | neg |
| 12. | Numri i konsumatorëve aktiv (nr) | 4,290 | 4,254 | 100.85 | poz |
| 13. | Numri i konsumatorëve pa matje (nr) | 0 | 2 | 0.00 | poz |
| 14. | Faturimi i ujit me ujëmatës (m$^3$) | 136,795 | 136,734 | 100.04 | poz |
| 15. | Proporcioni i konsumatorë me ujëmatës (%) | 100.00 | 99.95 | 100.05 | poz |
| 16. | UPF në (%) | 46.71 | 45.48 | 102.70 | neg |
| 17. | Norma e mbulimit operativ | 1.02 | 1.07 | 95.53 | neg |
| 18. | Fitimi /humbja operative | 1,469 | 4,568 | 32.16 | neg |
| 19. | Kostoja për njësi (€/m$^3$) | 0.27 | 0.26 | 101.48 | neg |
| 20. | Efikasiteti i stafit ('000 kons) | 3.96 | 4.00 | 99.16 | poz |

*Tabela 15. Raporti i performancës operative dhe financiare për Njësinë Operative në Vitisë për TM3/2024, krahasimi me TM3/2023*

| | Indikatorët – Viti | TM3 /2024 | TM3 /2023 | Realizimi 2043/2023 (në %) | Trendi 2024/2023 |
|---|---|---|---|---|---|
| 1. | Prodhimi i ujit ($m^3$) | 448,640 | 328,240 | 136.68 | poz |
| 2. | Faturimi ($m^3$) | 137,049 | 95,841 | 143.00 | poz |
| 3. | Uji i pafaturar ($m^3$) | 311,591 | 232,399 | 134.08 | neg |
| 4. | Faturimi (€) | 74,286 | 55,084 | 134.86 | poz |
| 5. | Arkëtimi (€) | 58,729 | 57,216 | 102.64 | poz |
| [illegible] | Shkalla e arkëtimit (%) | 79.06 | 103.87 | 76.11 | neg |
| 7. | Shpenzimet (€) | 59,710 | 53,444 | 111.72 | neg |
| 8. | Numri i konsumtorëve të regjistruar (total) | 4,797 | 4,278 | 112.13 | poz |
| 9. | Numri i konsumatorëve me ujëmatës (nr) | 4,150 | 3,619 | 114.67 | poz |
| 10. | Numri i konumatorëve me konsum zero (nr) | 2,405 | 1,916 | 125.52 | neg |
| 11. | Konsumatorë të rinj (nr) | 139 | 207 | 67.15 | neg |
| 12. | Numri i konsumatorëve aktiv (nr) | 4,248 | 3,711 | 114.47 | poz |
| 13. | Numri i konsumatorëve pa matje (nr) | 98 | 92 | 106.52 | poz |
| 14. | Faturimi i ujit me ujëmatës ($m^3$) | 114,333 | 94,186 | 121.39 | poz |
| 15. | Proporcioni i konsumatorë me ujëmatës (%) | 97.69 | 97.52 | 100.17 | poz |
| 16. | UPF në (%) | 69.45 | 70.80 | 98.09 | poz |
| 17. | Norma e mbulimit operativ | 1.24 | 1.03 | 120.71 | poz |
| 18. | Fitimi/humbja operative | 14,576 | 1,640 | 888.78 | poz |
| 19. | Kostoja për njësi (€/$m^3$) | 0.13 | 0.16 | 81.74 | poz |
| 20. | Efikasiteti i stafit ('000 kons) | 4.71 | 4.58 | 102.78 | neg |

*Tabela 16. Treguesit – të hyrat dhe shpenzimet operative për TM3/2024 dhe krahasimi me TM3/2023*

| Të hyrat dhe shpenzimet | TM3 2024 | TM3 2023 |
|---|---|---|
| Të hyrat nga shitja e ujit | 715,306.00 | 660,311.00 |
| Të hyrat nga shërbimet | 18,483.00 | 24,361.00 |
| Të hyrat nga grantet | 108,780.00 | 101,920.00 |
| **Të hyrat totale** | **842,569.00** | **786,592.00** |
| Shpenzimet e personelit | (373,916.00) | (361,955.00) |
| Shpenzimet e energjisë | (81,014.00) | (77,450.00) |
| Shpenzimet për derivate/analiza/kimikale | (24,233.00) | (31,154.00) |
| Shpenzimet për mirëmbajtje | (22,967.00) | (18,581.00) |
| Shpenzime tjera | (24,510.00) | (34,452.00) |
| **Shpenzimet totale operative[6]** | **(526,640.00)** | **(523,592.00)** |
| Shpenzimet jo operative | (20,136.00) | (36.00) |
| Shpenzimet e zhvlerësimit | (166,643.00) | (160,843.00) |
| **Gjithsej shpenzimet** | **(713,419.00)** | **(684,471.00)** |

[6] Ndryshim/plotësim sipas kërkesave të KA-së.

**5. Pasqyrat Financiare – shtator 2024/2023**

**Pasqyra e pozitës financiare**

**deri më 30 shtator 2024**

| | Shënimi | TM3 2024 | TM3 2023 |
|---|---|---|---|
| | | € | € |
| **PASURITË** | | | |
| **Pasuritë afatshkurtra** | | | |
| Paraja dhe ekuivalentët e parasë | 1 | 912,904.00 | 640,293.00 |
| Llogaritë e arkëtueshme tregtare dhe të tjera | 2 | 3.631,609.00 | 3,715,493.00 |
| Stoqet | 3 | 458,325.00 | 339,946.00 |
| Pasuritë e tjera afatshkurtra | 4 | 72,839.00 | 63,285.00 |
| **Gjithsej pasuritë afatshkurtra** | | **5,075,677.00** | **4,758,963.00** |
| **Pasuritë afatgjata** | | | |
| Prona, pajisjet dhe impiantet | 5 | 7,488,048.00 | 7,078,580.00 |
| Prona investuse | | - | |
| Investimet në vijim | | 1,955,155.00 | 972,646.00 |
| Pasuritë e paprekshme | | | |
| Pasuritë e shtyra tatimore | | | |
| Pasuritë e tjera afatgjata | | | |
| **Gjithsej pasuritë afatshkurtra** | | 9,443,203.00 | 8,051226.00 |
| **Gjithsej pasuritë** | | **14,518,880.00** | **12,810,189.00** |
| **DETYRIMET DHE EKUITETI** | | | |
| **DETYRIMET** | | | |
| **Detyrimet afatshkurtra** | | | |
| Llogaritë e pagueshme tregtare dhe të tjera | 6 | 113,325.00 | 53,937.00 |
| Kreditë dhe huatë, pjesa afatshkurtër | | - | - |
| Tatimet e pagueshme aktuale | | - | - |
| Të hyrat e shtyra | | - | - |
| Provizionet afatshkurtra | | | |
| Detyrimet e tjera afatshkurtra | 7 | 179,594.00 | 108.792,00 |
| **Gjithsej detyrimet afatshkurtra** | 8 | **292,919.00** | **162,729.00** |
| | | | |
| **Detyrimet afatgjata** | | | |
| Kreditë dhe huatë, pjesa afatgjate | | - | - |
| Provizionet afatgjate | | - | - |
| Detyrimet ndaj lizingut pjesa afatgjate | | | |

| | | | |
|---|---|---|---|
| Detyrimet nga e shtyra (grantet) | 9 | 6,280,646.00 | 4,794,775.00 |
| Detyrime tjera afatgjate | | - | - |
| **Gjithsej detyrimet afatgjate** | | 6,280,646.00 | 4,791.775.00 |
| | | | |
| **Gjithsej detyrimet** | | **6,573,565.00** | **4,957,504.00** |
| | | | |
| **EKUITETI** | | | |
| Kapitali aksionar | 10 | 8,074,519.00 | 8,074,519.00 |
| Fitimet/humbjet e bartura | | (129,204.00) | (221,834.00) |
| Rezervat e tjera | | - | - |
| **Gjithsej ekuiteti** | | **7,945,315.00** | **7,852.685,00** |
| | | | |
| **Gjithsej ekuiteti dhe detyrimet** | | **14,518.880.00** | **12,810,189.00** |

## Pasqyra e të ardhurave gjithëpërfshirëse

### më 30 shtator 2024

| | Shënimi | TM3 2024 | TM3 2023 |
|---|---|---|---|
| | | € | € |
| Të hyrat | 11 | 715,306.00 | 660,311.00 |
| Të hyrat e tjera | | 18,483.00 | 24.361.00 |
| Të hyrat nga grantet | | 108,780.00 | 101,920.00 |
| **Total të hyrat** | | **842,569.00** | **786,592.00** |
| | | - | - |
| Shpenzimet e shpërndarjes (personelit) | 12 | (373,916.00) | (361,955.00) |
| Shpenzimet administrative (zhvlerësimit) | 13 | (166,643.00) | (160,843.00) |
| Shpenzimet energjisë elektrike | | (81,014.00) | (77,450.00) |
| Shpenzimet e mirëmbajtjes | | (22,967.00) | (18,581.00) |
| Shpenzimet e kimikateve/derivate/analiza të ujit | | (24,233.00) | (31,154.00) |
| Shpenzimet e tjera operative | | (44,646.00) | (34,488.00) |
| Total shpenzimet | | **(713,419.00)** | **(684,471.00)** |
| **Fitimi /(humbja) operative** | | 129,150.00 | 102,121.00 |
| Shpenzimet financiare | | - | - |
| Të ardhurat financiare | | - | - |
| **Fitimi/(humbja para tatimit)** | | 129,150.00 | 102,121.00 |
| Shpenzimet e tatimit në fitim | | - | - |
| **Fitimi /(humbja) i/e periudhës** | 14 | 129,150.00 | 102,121,00 |
| **Të ardhurat tjera gjithëpërfshirëse** | | | |
| Diferencat këmbimore nga përkthimi i pasqyrave financiare të operacioneve të huaja, neto nga tatimi | | | |
| **Të ardhurat tjera gjithëpërfshirëse të periudhes** | | - | - |
| **Gjithsej të ardhurat /(humbjet) gjithëpërfshirëse të periudhes** | | - | - |

**Pasqyra e ndryshimeve në ekuitet**

**për vitin që përfundon më 30 shtator 2024**

| | Kapitali aksionar € | Fitimet e mbajtura € | Rezervat e tjera € | Gjithësej € |
|---|---|---|---|---|
| **Gjendja më 30 shtator 2024** | 8,074,519.00 | (258,354.00) | - | 7,816,165.00 |
| Fitimi/(humbja) i/e vitit (TM3/24) | - | 129,150.00 | - | 129,150.00 |
| Diferencat nga përkthimet valutore | - | - | - | - |
| Dividentat | - | - | - | - |
| Deponimet e kapitalit shtesë | - | - | - | - |
| Ndarje e rezervave | - | - | - | - |
| **Gjendja më 30 shtator 2024** | 8,074,519.00 | (129,204.00) | - | 7,945,315.00 |

**Pasqyra e rrjedhjes së parasë**

**për vitin që përfundon më 30 shtator 2024**

| | Shënimi | TM3 2024 | TM3 2023 |
|---|---|---|---|
| | | € | € |
| Rrjedha e parasë nga aktivitetet operative | | | |
| (Fitimi)/(humbja) i/e periudhës | | 129,150.00 | 102,121.00 |
| Rregullimet për zërat jo në para të shpenzimeve dhe të hyrave | | - | - |
| Zhvlerësimi i pronës, pajisjeve dhe impianteve | | 166,643.00 | 160,843.00 |
| Dëmtimi i pronës, pajisjeve dhe impianteve | | - | - |
| Amortizimi i pasurive të paprekshme | | - | - |
| Ndryshimi i vlerës së pronës investuese | | - | - |
| Të ardhurat financiare | | - | - |
| Shpenzimet financiare | | - | - |
| (Fitimi)/(humbja) nga shitja e pronës, fabrikës dhe pajisjeve | | - | - |
| Shpenzimet e tatimit në fitim | | - | - |
| | | 295,793.00 | 262,964.00 |
| Ndryshimet në pasuritë dhe detyrimet operative | | | |
| (Rritja)/(zvogëlimi) në llogaritë e arkëtueshme tregtare dhe të tjera | | (83,830.00) | (578,536.00) |
| (Rritja)/(zvogëlimi) në stoqe | | (118,379.00) | (65,851.00) |
| (Rritja)/(zvogëlimi) në pasuritë e tjera | | (9,554) | (3,921.00) |
| (Rritja) /(zvogëlimi) në llogaritë e pagueshme tregtare dhe të tjera | | (59,388.00) | (89,043.00) |
| (Rritja)/(zvogëlimi) në detyrimet e tjera | | (70,802.00) | (55,081.00) |
| (Rritja)/(zvogëlimi) në detyrimet e tjera nga grantet | | 1,485,871.00 | (42,603.00) |
| Tatimi në fitim i paguar | | - | - |
| Interesi i paguar | | - | - |
| **Rrjedha neto e parasë nga aktivitetet operative** | | 1,867,751.00 | 881,091.00 |

| | | |
|---|---|---|
| **Rrjedha e parasë nga aktivitetet investuese** | | |
| Pagesat për blerjet e pronës, pajisjeve dhe impianteve | (1,595,140.00) | (890,794.00) |
| Arkëtimet për shitjen e pronës, pajisjeve dhe impianteve | - | - |
| Pagesat për blerjet e pasurive të paprekshme | - | - |
| Arkëtimet për shitjen e pasurive të paprekshme | - | - |
| Interesi i arkëtuar | - | - |
| Divdentat e paguara | - | - |
| **Rrjedha neto e parasë nga aktivitetet investuese** | (1,595,140.00) | (890,794.00) |
| **Rrjedha e parasë nga aktivitetet financuese** | | |
| Deponimet e kapitalit shtesë | - | - |
| Dividentat e paguara | - | - |
| Arkëtimet nga kreditë dhe huatë | - | - |
| Ripagimi i kredive dhe huave | - | - |
| **Pagesat e lizingut financiar** | | |
| **Rrjedha neto e parasë nga aktivitetet financuese** | - | - |
| **(Rritja) /(zvogëlim) neto e parasë dhe ekuivalentëve të parasë** | 272,611.00 | (9,703.00) |
| Paraja dhe ekuivalentët e parasë në fillim të periudhës | 640,293.00 | 649,996.00 |
| **Paraja dhe ekuivalentët e parasë në fund të periudhës** | **912,904.00** | **640,293.00** |

5.3.1. Shpalosje e shënimeve shpjeguese për pasqyrat financiare deri më 30 shtator 2024

**Shënimet shpjeguese 1. Paraja dhe ekuivalentët e parasë**

*Tabela 17. Paraja dhe ekuivalentet e parasë përfshijnë paranë në banka dhe në arkë*

| Përshkrimi | TM3 2024 | TM3 2023 |
|---|---|---|
| Paratë në arka | 1,173.08 | 1,238.00 |
| Paratë në banka | 911,731.00 | 639,055.00 |
| **Gjithsej** | **912,904.08** | **640,293.00** |

*Tabela 18. Llogaritë e arkëtueshme dhe kërkesat tjera*

**Shënimet shpjeguese 2. Llogaritë e arkëtueshme dhe kërkesat tjera**

| | TM3 2024 | TM3 2023 |
|---|---|---|
| **Llogaritë e arkëtueshme** | **8,218,482.00** | **8,312,867.00** |
| Provizioni i llogarive – amvisëri | 3,607,876.00 | 3,610,841.00 |
| Provizioni i llogarive – biznes | 378,696.00 | 384,132.00 |
| Provizioni i llogarive – institucione | 447,985.00 | 450,386.00 |
| Lejimet e bartura për shërbimet | 152,016.00 | 152,016.00 |
| Total provizioni | **4,586,873.00** | **4,597,374.00** |
| **Neto të arkëtueshmet** | **3,631,609.00** | **3,715,493.00** |

**Shënimet shpjeguese 3. Stoqet**

Ndërmarrja përdor metodën e vlerësimit të stoqeve sipas sistemit të vazhdueshëm. Regjistrimi bëhet në momentin e pranimit të e-mailit me metodën e pranimit të mallit, me metodën e së cilës përcaktohet kosto e stoqeve sipas vlerës mesatare.

*Tabela 19. Stoqet*

| Përshkrimi - stoqet | TM3 2024<br>Vlera në € | TM3 2023<br>Vlera në € |
|---|---|---|
| Depo Kamenicë | 51,741.33 | 46,823.00 |
| Depo Baja – kimikale | 246.02 | 39.56 |
| Depo e mbyllur Gjilan | 199,850.01 | 168,929.48 |
| Depo e hapur Gjilan | 34,312.21 | 22,167.16 |
| Depo administrative | 368.55 | 535.74 |
| Depo materiale jo funksionale | 13.51 | - |
| Depo tek penda | 37,371.59 | 30,592.00 |
| Depo Përlepnicë, Gjilan | 60,105.52 | 8,804.00 |
| Depo Viti | 58,942.22 | 51,707.00 |
| Material depo Velekincë/Gjilan | 6,181.86 | 1,932.00 |
| Material revers | 2,428.38 | 2,060.00 |
| Depo punëtoria e ujëmatësve | 6,763.67 | 6,357.00 |
| | - | - |
| **Gjithsej** | **458,325.01** | **339,946.94** |

**Shënimet shpjeguese 4. Pasuritë tjera afatshkurta**

*Tabela 20. Pasuritë tjera afatshkurta*

| | TM3 2024 | TM3 2023 |
|---|---|---|
| Parapagimet e marra | 64,738.00 | 63,077.00 |
| Paradhënie të pranuara | 8,100.00 | 4,494.00 |
| **Gjithsej** | **73,656.00** | **67,571.00** |

**Shënimet shpjeguese 5. Pasuritë afatgjata – pronat, impiantet dhe pajisjet**

*Tabela 21. Pronat, impiantet dhe pajisjet*

| Emërtimi | TM3 2024 | TM3 2023 |
|---|---|---|
| Toka | 1,902,000.00 | 1,902,000.00 |
| Ndërtesa | 4,886,622.00 | 4,863,572.00 |
| Rrjeti i ujësjellësit, instalime teknike, makineri, pajisje | 5,705,131.00 | 5,670,473.00 |
| Mjete transporti | 418,427.00 | 354,277.00 |
| Mobile dhe pajisje zyre | 2,299,437.00 | 2,273,878.00 |
| Pajisje informative | 78,776.00 | 40,436.00 |

| | | |
|---|---|---|
| Rrjeti i ujësjellësit | 1,912,576.00 | 1,029,710.00 |
| Investime në vijim | 45,785.00.00 | 37,310.00.00 |
| Të tjera | 35,482.00 | 35,482.00 |
| **Gjithsej** | **17,291,468.00** | **16,214,373.00** |

**Shënimet shpjeguese 6. Investimet në vijim/projektet**

- "Ndërtimi i kanalizimit në shtratin e lumit në Dobërçan – Gjilan".
- "Ndërrimi i gypave të ujësjellësit për Gjilan, Viti dhe Kamenicë".
- "Ndërtimi i rrjetit të ujësjellësit përgjatë rrugës nga tuneli deri në përfundim të rrugës magjistrale në fshatin Pasjak, Komuna e Gjilanit".
- "Kyçjet individuale për fshatrat\Hodonoc, Dajkoc në Komunën e Kamenicës".
- "Ndërtimi i rrjetit të ujësjellësit në fshatin Karaçevë e Epërme në Komunën e Kamenicës".
- "Impianti i ujërave të zeza – ITUZ".
- "FLOWS-CS-CQ-09".
- "Hartimi, ndërrimi i gypave dhe rehabilitimi i rrjetit të ujësjellësit, brenda zonës së shërbimit".
- "Kyçjet individale për fshatrat Muçivërcë, Dajkoc, Hodonoc, Novosellë, Shipashnicë e Ulët, Roganë – Komuna e Kamenicës".
- "Ndërtimi i rrjetit të ri të ujësjellësit dhe kalimi i kyçjeve individuale të konsumatorëve nga gypat AC në atë HDPE".
- "Rehabilitimi i shtatë puseve, pusetës kryesore dhe impiantit në Velekincë".
- "Shtimi i kapacitetit të ujit përmes restaurimit të rezervuarit, hapjës së puseve dhe ndërtimit të rrjetit në fshatin Berivojcë"
- " Ndërtimi i garazhave dhe depos"

**Shënimet shpjeguese 7. Llogaritë e pagueshme për TM3 2024**

Tabela 22. *Llogaritë e pagueshme*

| Emërtimi i Furnitorit | Detyrimi |
|---|---|
| KEDS | 25,812.38 |
| Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor | 11,462.17 |
| B.I. "BEKIM HAZIRI" | 10,572.20 |
| "INFINIT" Sh.P.K. | 9,059.50 |
| "TEUTA M" Sh.P.K. | 7,924.00 |
| "HIDROTERM" | 7,909.89 |
| ECO – HIGJIENA | 4,271.67 |
| Drejtoria e Zhvillimit Ekonomik | 3,693.81 |
| "Pëllumb Gjinolli" B.I | 3,300.00 |
| HIB PETROL | 1,907.25 |
| Furnitorë të tjerë | 27,413.00 |
| **Gjithsej** | **113,325.37** |

**Shënimet shpjeguese 8. Detyrimet tjera afatshkrutra**

*Tabela 23. Detyrimet tjera afatshkurtra*

| Përshkrimi | TM3 2024 | TM3 2023 |
|---|---|---|
| Llogaritë e pagushme | 113,325.37 | 53,937.00 |
| Detyrimet tjera afatshkurta | 179,594.00 | 108,792.00 |
| **Gjithsej** | **292,919.00** | **162,729.00** |

**Shënimet shpjeguese 9. Të hyrat e shtyera/grantet**

*Tabela 24. Të hyrat e shtyra /grantet*

| Përshkrimi | TM3 2024 | TM3 2023 |
|---|---|---|
| Të hyrat e shtyra në fillim të vitit | 6,280,646.00 | 4,794,775.00 |
| **Të hyrat e shtyra me 30 shtator** | **6,280,646.00** | **4,794,775.00** |

**Shënimet shpjeguese 10. Ndryshimi në ekuitet**

*Tabela 25. Ekuiteti*

| | TM3 2024 | TM3 2023 |
|---|---|---|
| **Ekuiteti me 30 shtator 2024** | 7,945,315.00 | 7,852,685.00 |
| | **7,945,315.00** | **7,852,685.00** |

**Shënimet shpjeguese 11. Të hyrat**

*Tabela 26. Të hyrat*

| | TM3 2024 | TM3 2023 |
|---|---|---|
| Të hyrat nga shitja e ujit | 715,306.00 | 660,311.00 |
| Të hyrat nga shërbimet | 18,483.00 | 24,361.00 |
| Të hyrat nga grantet | 108,780.00 | 101,920.00 |
| **Të hyrat totale** | **842,569.00** | **786,592.00** |

**Shënimet shpjeguese 12. Shpenzimet e shpërndarjes**

*Tabela 27. Shpenzimet e shpërndarjes*

| | TM3 2024 | TM3 2023 |
|---|---|---|
| Shpenzimet e personelit | (373,916.00) | (361,955.00) |

**Shënimet shpjeguese 13. Shpenzimet administrative të tjera**

| *Tabela 28. Shpenzime administrative të tjera* | TM3 2024 | TM3 2023 |
|---|---|---|
| Shpenzimet administrative (zhvlerësimit) | (166,643.00) | (160,843.00) |
| Shpenzimet energjisë elektrike | (81,014.00) | (77,450.00) |
| Shpenzimet e mirëmbajtjes | (22,967.00) | (18,581.00) |
| Shpenzimet e kimikateve/derivate/analiza të ujit | (24,233.00) | (31,154.00) |
| Shpenzimet e tjera operative | (44,646.00) | (34,488.00) |
| **Total shpenzimet** | **(339,503.00)** | **(322,516.00)** |

**Shënimet shpjeguese 14. Fitimi (humbja) para tatimit e vitit**

*Tabela 29. Fitimi (humbja) para tatimit*

| | |
|---|---|
| 30.09.2024 | 129,150.00 |
| 30.09.2023 | 102,121.00 |

**Shpalosja e ndryshimeve në ekuitet**

*Tabela 30. Ndryshimet në ekuitet*

| | |
|---|---|
| Kapitali aksionar | 8,049,519.00 |
| Fitimi i vitit paraprak | 102,121.00 |
| Fitimi/humbjet e bartura | (258,354.00) |
| Fitimi/humbja e vitit aktual | 129,150.00 |
| Fitimi/humbjet e bartura | (129,204.00) |

# 6. RAPORTI I ZYRËS SË PROKURIMIT

Zyra e Prokurimit gjatë tremujorit të tretë të vitit 2024 ka pranuar disa kërkesa me shkrim, për furnizime, shërbime dhe punë, nga njësitë përkatëse të cilat janë inicuar nga menaxhmenti i Ndërmarrjes, ku këto kërkesa pastaj janë proceduar varësisht prej prioriteteve dhe konform rregullave të prokurimit.

*Tabela 31. Aktivitetet e zyrës së prokurimit gjatë TM3/2024 – vlerë minimale*

| Data: | Lloji i kontratave: | Operatori ekonomik: | Vlera: |
|---|---|---|---|
| 18.07.2024 | Furnizim me pllomba të ujëmatësave për gjithë zonën shërbimit (Gjilan, Kamenicë dhe Viti) | "X" Sh.P.K. | 960.00€ |
| 19.08.2024 | "Furnizim me server për Zyrën e Gis-it" | "WIN 007" Sh.P.K. | 950.00€ |
| 16.09.2024 | Furnizim me laptop për Kryeshefin Ekzekutiv. | "ZZ ICT" Solutions L.L.C. | 815.00€ |

*Tabela 32. Aktivitetet e zyrës së prokurimit gjatë TM3/2024 – kuotim i çmimit*

| Data | Lloji i kontratave | Operatori ekonomik | Shuma |
|---|---|---|---|
| 18.07.2024 | Furnizim me telefona dhe printer[7] | "INFINITT" Sh.P.K. | 1,924.00€ |
| 30.08.2024 | "Furnizim me zarfa, fasiklla varëse dhe makina për detektim të kartmonedhave fallco" | Nita Macula B.I. | 5,720.00€ |
| 11.09.2024 | Rregullimi i rrethojës te Guri i Hoxhës në fshatin Përlepnicë | K.N.T.SH. "Teuta – M" Sh.P.K. | 6,900.00€ |

*Tabela 33. Aktivitetet e prokurimit gjatë TM3/2024 – procedurë e hapur – vlerë e mesme*

| Data | Lloji i kontratave | Operatori ekonomik | Shuma |
|---|---|---|---|
| 18.07.2024 | Shtimi i kapacitetit të ujit përmes restaurimit të rezervuarit, hapjës së puseve dhe ndërtimit të rrjetit në fshatin Berivojcë | Grup i Operatorëve Ekonomik Cubic Group Sh.P.K.; NNT ABC SH.P.K. | 129,852.00€ |
| 23.08.2024 | Ndërtimi i garazhave dhe depos[8] | Grup i Operatorëve Ekonomik "Cubic Group" Sh.P.K., | 49,999.50€ |

[7] Telefonat janë për të punësuarit e Gjilanit dhe Kamenicës, ndërsa printeri është për Zyrtaren e arkivës.

[8] Ndërtimi i garazheve dhe depos do të bëhet në vendparkingun ku janë të vendosura makineria e rëndë e KRU Hidromorava.

| | | | |
|---|---|---|---|
| 03.09.2024 | Furnizim me ujëmatësa, pllomba dhe bllokues | “Hexagon Construction” Sh.P.K.<br>“X” Sh.P.K. | 53,750.00€ |
| 26.09.2024 | Furnizimi dhe instalimi me elektropompa | “EJONA” Sh.P.K. | 40,000.00€ |

***Tabela 34. Aktivitetet e prokurimit gjatë TM3/2024 – procedurë e hapur – vlerë e madhe***

| Data | Lloji i kontratave | Operatori ekonomik | Shuma |
|---|---|---|---|
| 25.07.2024 | Ndërtimi i rrjetit të ujësjellësit në fshatin Cërnicë – Komuna e Gjilanit | Grup i Operatorëve Ekonomik K.N.T.SH. “Teuta – M” SH.P.K.; Infra-Plus SH.P.K. | 750,216.36€ |

***Tabela 35. Aktivitetet e prokurimit gjatë TM3/2024 – Procedurë e negociuar pa publikim të njoftimit të kontratës- Aneks Kontratë***

| Data | Lloji i kontratave | Operatori ekonomik | Shuma |
|---|---|---|---|
| 31.07.2024 | Furnizimi dhe instalimi i termopompave dhe kondicionerve me inverter – Aneks Kontratë | “Adnani Group” Sh.P.K. | 3,000.00€ |

# 7. RAPORTI PËR CILËSI TË UJIT PËR TM3– 2024

## 7.1. Cilësia e ujit

Raporti i tremujorit të tretë të vitit 2024 jep një pasqyrë të përmbledhur të cilësisë së ujit të pijshëm nëpër të gjitha zonat e KRU "Hidromorava" Sh.A.

Bazuar në rezultatet e analizave fiziko – kimike dhe mikrobiologjike të punura në laboratorin qendror të KRU "Hidromorava", në Qendrën Rajonale të Shëndetit Publik në Gjilan – QRSHP si dhe Institutin Kombëtar të Shëndetësisë Publike - IKSHPK, cilësia e ujit për periudhen e tremujorit të tretë është rreth 99% në përputhje me vlerat parametrike për ujin e pijshëm.

- Duke u bazuar në Planin për Monitorim të Cilësisë së Ujit, në KRU "Hidromorava", monitorimi i cilësisë së ujit bëhet nëpermjet dhjetë zonave të ndara sipas karakteristikave të ujit.

1. **Zona HM 01**– burimi "Guri i Hoxhës" dhe "Liqeni i Përlepnicës", kjo është zona më e madhe në KRU "Hidromorava";
2. **Zona HM 02** – burimet e ujit në "Pasjan", "Fabrika e Përpunimit të Ujit në Velekincë";
3. **Zona HM 03** – burimi "Baja";
4. **Zona HM 04** – zonat rurale (burimet e ujit në Malishevë, Zhegër, Doberqan, Llovcë dhe Bilinicë);
5. **Zona HM 05** – Letnica, Fabrika për Përpunimin e Ujit në Letnicë;
6. **Zona HM 06** – burimet e ujit në fshatin Pozharan;
7. **Zona HM 07** – burimet e ujit në Kamenicë, fshatin Karaqevë dhe Shipashnicë;
8. **Zona HM 08** – burimet e ujit në fshatin Topanicë dhe Koretin;
9. **Zona HM 09** – burimet e ujit në fshatin Makresh, Novoberdë;
10. **Zona HM 10** – burimet e ujit në Ranillug dhe fshatin Ropotovë.

Parametrat të cilat kontrollohen për ta vërtetuar cilësinë e ujit janë:

- ***Parametrat fizik të cilët janë punuar janë***: era, ngjyra, shija, përqueshmëria elektrike, turbullira fortësia e ujit.
- ***Parametrat kimik të cilët janë punuar:*** pH, klori residual, amoniaku, nitritet, nitratet, sulfatet, hekuri, mangani, kalciumi, magnezi, shpenzimi i $KMnO_4$, fosfatet, kloruret, alumini.
- ***Parametrat mikrobiologjik të cilët janë punuar:*** numri i tërësishëm i baktereve koliforme në 100 ml, bakteret koliforme me prejardhje fekale në 100 ml, numri i tërësishëm i baktereve të gjalla në 1 ml në 37 gradë celsius, streptokoket me prejardhje fekale në 100ml.

Në baza tre mujore punohen edhe metalet e rënda, trehalometanet THM, si dhe karboni total organik TOC.

Në përgjithësi, cilësia e ujit në KRU "Hidromorava" Sh.A., gjatë muajve korrik, gusht dhe shtator i ka përmbushur standardet e kërkuara për ujë të pijes, ku në shumicën e mostrave kemi pasur përputhje të vlerave parametrike për ujë të pijes, përveç në disa raste të rralla që kemi pasur mospërputhje të vlerave parametrike për të cilat janë ndërmarrë masa të menjëhershme dhe konsumatorët janë informuar me kohë përmes mjeteve te informimit.

Gjatë tremujorit të tretë të vitit 2024 kemi pasur mospërputhje të vlerave parametrike në këto zona:

**Në muajin korrik ka pasur mungesë të klorit të lirë në ujë në këto zona:**

- **Në zonën e furnizimit HM06** – në stacionin e pompimit në Pozharan;
- **Në zonen e furnizimit HM07** – në lagjen Malësia në Kamenicë;
- **Në zonën e furnizimit HM08** – në fshatin Topanicë;
- **Në zonën e furnizimit HM09** – në Stacionin e Pompimit në Novobërdë;

Në këto zona të furnizimit uji është dozuar vazhdimisht me hypoklorit natriumi, mirëpo për shkak të temperaturave të larta në këtë periudhe, përqëndrimi i hypoklorit natriumit zvogëlohet dhe për këtë arsye vlera e klorit të lirë në ujë ka qenë 0. Kjo situatë ka qenë momentale pasi që stafi i laboratorit e ka monitoruar vazhdimisht cilësinë e ujit dhe në momentin që është verejtur mungesa e klorit të lirë në ujë menjeherë është rritur doza e hypoklorit natriumit në ujë.

**Në muajin gusht ka pasur mungesë të klorit të lirë në ujë në këtë zonë:**

- **Në zonën e furnizimit HM09** – në Stacionin e Pompimit në Novobërdë, ka pasur mungesë të klorit për shkak të problemeve me pompën dozuese të klorit, mirëpo janë marrë masat menjeherë nga operatori i cili i mirëmbanë pomnpat dozuese të klorit.

**Në muajin shtator 2024 ka pasur mospërputhje të vlerave parametrike në këto zona:**

- **Në zonën e furnizimit HM01** – në Fabrikën për Përpunimin e Ujit në Përlepnicë kemi pasur ngritje të lehtë të vlerës së manganit në ujë, mirëpo kemi intervenuar me kohë duke e ndërruar nivelin e marjes së ujit në liqen, ku nga niveli i dytë kemi kaluar në nivelin e parë (sipër) dhe menjëherë vlerat janë normalizuar pa pasur nevojë për dozim me permanganat kaliumi.
- **Në zonën e furnizimit HM04** – në Stacionin e Pompimit në Dobërçan, Bilinicë dhe Llovcë ka pasur mungesë të klorit të lirë në ujë dhe menjëherë është intervenuar duke e rritur dozimin me klor.

***Shënim:*** Në disa prej rasteve kur kemi mungesë të klorit të lirë në ujë ka edhe prezencë të baktereve, p.sh. te rastet në: Novobërdë, Llovcë, Dobërçan, Kopërnicë, Lagjja Malësia, rezervuari në Velekincë dhe rezervuari në Letnicë.

# 8. DIVIZIONI PËR PRODHIMIN, IMPIANTET E UJIT DHE STACIONET E POMPIMIT

## 8.1. Furnizimi me ujë

Niveli i ujit në akumulacionin e Përlepnicës, gjatë tremujorit të tretë të vitit 2024 ka qenë në kuotën 25m. Gjatë kësaj periudhe edhe në burimet të tjera në Gjilan si "Baja", "Guri i Hoxhës" dhe puset në Velekincë, situata ka qenë gjithashtu e mirë por me zvogëlim të kapaciteteve të ujit. Meqë kishte sasi të mjaftueshme të ujit nga burimet e ujit, edhe furnizimi me ujë të pijshëm për këtë periudhë ka qenë i kënaqshëm. Sa i përket funksionimit të stacioneve të pompimit, në këtë periudhë mund të themi se ka një situatë të qëndrueshme.

Tremujori i tretë i vitit 2024 është karakterizuar me disa probleme teknike, kryesisht me defekte në elektropompa, siç ishte rasti në Llovcë dhe Malishevë, mandej defektet në procesin komandimit në mes të rezervuarëve dhe stacioneve të pompimit, mirëpo këto defekte janë evituar shumë shpejt nga ekipet tona.

Përfundimisht mund të themi se tremujori i tretë i vitit 2024 është karakterizuar me probleme të vogla, kur bëhet fjalë për funksionimin dhe furnizimin me ujë të pijshëm, të prodhuar/përpunuar nga impiantet dhe stacionet e pompimit.

## 8.2. Sasia e ujit të prodhuar, ujit të faturuar dhe humbjeve të ujit

Sasia e ujit të prodhuar dhe të faturuar, gjatë tremujorit të tretë të vitit 2024, sipas analizës së bërë nga koordinatorja për UPF-në, është paraqitur në tabelën nr. 36.

*Tabela 36. Sasia e ujit të prodhuar, faturuar dhe ujit të pafaturuar gjatë periudhës së TM3/2024*

| Burimi | Prodhimi ($m^3$) | Faturimi për ($m^3$) | UPF (%) |
|---|---|---|---|
| FPU Përlepnicë dhe Guri i Hoxhës | 1,689,112 | 957,278 | 43.3 |
| FPU Velekincë | 288,518 | | |
| Baja*10 | 177,605 | | |
| Pasjan (komulative) | 16,071 | 12,524 | 22.0 |
| Malishevë e Ulët | 12,195 | 5,111 | 58.0 |
| Llovcë | 628 | 1,156 | -84.0 |
| Dobërçan*10 | 12,796 | 4,939 | 61.4 |
| Zhegër*10 | 66,470 | 34,334 | 48.3 |
| Bilinicë | 1,951 | 1,926 | 1.2 |

| | | | |
|---|---|---|---|
| FPU Letnicë – Viti | 287,550 | 72,811 | 74.6 |
| Trestenik | 64,740 | 20,158 | 68.8 |
| Pozharani | 93,340 | 42,728 | 54.2 |
| Ujësjellësi Letnicë | 3,010 | 1351 | 55.1 |
| Stacioni i pompimit 1, Kamenicë | 157,651 | | |
| Stacioni i pompimit 2, Kamenicë | 30,718 | | |
| Stacioni i pompimit 3, Kamenicë | 9,429 | 87,460 | 44.5 |
| Stacioni i pompimit 4, Kamenicë | 35,592 | | |
| Stacioni i pompimit 5, Kamenicë | 6,059 | | |
| Topanicë | 32,102 | 17,204 | 46.4 |
| Kopernicë & Kolloleç | 12,210 | 9,812 | 19.6 |
| Koretin | 27,498 | 11,355 | 58.7 |
| Shipashnicë | 16,270 | 6,351 | 60.9 |
| Karaçevë | 10,988 | 4,613 | 58.0 |
| Ranillug | 19,702 | 8,910 | 54.7 |
| Ropotovë | 3,124 | 3068 | 1.7 |
| Boston, Qulkoc, Makresh | 15,964 | 3005 | 81.1 |
| Koretisht& Pasjak | 0 | 0 | #DIV/0! |
| **Prodhimi total m³/TM3** | **2,543,372** | **1,306,094** | **48.6%** |

Sipas tabelës së përpiluar, rezulton se gjatë tremujorit të tretë të vitit 2024 është prodhuar ujë i pijshëm në sasi prej: 2,543,372 $m^3$, është faturuar 1,306,094 $m^3$ dhe UPF rezulton në 48.6 %.

## 8.3. Mirëmbajta e rrjetit të ujësjellësit

Në përgjithësi në zonat e shërbimit gjatë tremujorit të tretë të vitit 2024, kemi pasur 590 intervenime të natyrave të ndryshme si rrjedhje/plasaritje të gypave në rrjet, dëmtim i valvulave etj.
Në Njësinë Operative në Gjilan kanë qenë (401) intervenime, në Njësinë Operative në Kamenicë (133) intervenime, në Njësinë Operative në Viti (39) intervenime, në Komunën e Ranillugut (5) intervenime dhe në Komunën e Novobërdës (12) intervenime, ndërsa në Komunën e Parteshit nuk ka pasur intervenime në rrjetin e ujësjellësit.

*Tabela 37. Zona e shërbimit, numri dhe natyra e defekteve të ndodhura gjatë periudhës së TM3/2024*

| Zona e shërbimit | Numri i defekteve | Lagjet/rrugët/vendbanimet | Natyra e defekteve |
|---|---|---|---|
| Gjilan | 401 | Fshatrat: Dobërçan, Shillovë,Verbicë e Kmetovcit, Livoç i Ulët, Velekincë, Pasjak, Përlepnicë, Zhegër, lagjet: "Arbëria", Rr. "Shyt Mareci", Rr. "Isa Kastrati", Rr. "Isa Boletini", Rr. "Mulla Idrizi", Rr. "Lekë Dukagjini", Rr. "Fehmi Agani", Rr. "Gazmend Zajmi", Rr. "Muharrem Ibrahimi", Rr. "Nik Prela", Rr. Vëllezërit Gërvalla", Rr. "Ali Pashë Tepelena", Rr. "Bajram Llovca", Rr. "Mulla Idrzi", Rr. "Arben Ramadani", Rr. "Hysen Tërpeza", Rr. "Makfire Deda", Rr. "Mbretëresha Teutë", Rr. "Halim Orana", Rr. "Limon Staneci", Rr. "Beqir Musliu", Rr. "Idriz Seferi", Rr. "Ali Hadri", Rr. "Ahmet Malisheva", Rr. "Nafije Gashi", Rr. "Esat Berisha", Rr. "Shaban dhe Sami Ukshini", Rr. "Adem Jashari", Rr. "Gazmend Zajmi", Rr. "William Shekspir", Rr. "Afrim Gagica", Rr. "Nazim Budrika", Rr. "Xheladin Kurbaliu", Rr. "Fatmir Ibishi", Rr. "Mulla Idrizi", Rr. "Mehmet Akif Ersoj", Rr. "Muahrrem Ibrahimi", Rr. "Elena Gjika", Rr. "Dajti", Rr. "Skifter Arifi", Rr. "Arben Ramadani", Rr. "Ahmet Gashi", Rr. "Hamdi Kurteshi", Rr. "Haqif Tetova", Rr. "Xhemajl Mustafa", Rr. "7 Shtatori", Rr. "Vehbi Ibrahimi", Rr. "Igballe Prishtina", Rr. "7 Shtatori", Rr. "Ibrahim Rugova", Rr. "Sylë Zarbinca", Rr. "Abdullah Presheva", Rr. "Elekna Gjika", Rr. "Vudro Villson", Rr. "Bajram Llovca", Rr. "Ramiz Cërnica", Rr. "Muharrem Ibrahimi", Rr. "Xheladin Kurbaliu", Rr. "Fatmir Ibishi", Rr. "Mulla Idrizi", Rr. "Mehmet Akif Ersoj", Rr. "Muahrrem Ibrahimi", Rr. "Elena Gjika", Rr. "Dajti", Rr. "Skifter Arifi", Rr. "Arben Ramadani", Rr. "Ahmet Gashi", Rr. "Hamdi Kurteshi", Rr. Abdullah Tahiri", Rr. "Gazmend Zajmi", Rr. "Zija Shemsiu", Rr. "Mulla Idrizi", Rr. "Dardania 1", etj. | Rrjedhje në rrugë (222) dhe rrjedhje në puseta (179). |
| Novobërdë | 12 | Fshatrat: Tullar, Boston dhe Makresh. | Rrjedhje në rrugë (8) dhe rrjedhje në puseta (4). |

| | | | |
|---|---|---|---|
| | | | |
| **Ranillug** | 5 | Fshatrat: Ropotovë, Panqellë dhe Gllogoc. | Rrjedhje në rrugë (2) dhe rrjedhje në puseta (3). |
| **Kamenicë** | 133 | Fshatrat: Berivojcë, Shipashnicë e Epërme, Karaçevë e Poshtme, Koretin, Kolloleq, Topanicë, Kopërnicë, Rrugët: Rr."Vudro Wilson", Rr. "Ramadan Kastrati", Rr. "Skenderbeu", Rr."Besnik Maroca", Rr."Avdi Xhaqku", Rr."Nënë Teresa" , Rr."Nikolla Teslla", Rr."Sahit Baliq", Rr."Musli Ymeri", Rr."Dëshmorët e Kombit" , Rr."Rahim Beqiri" , Rr."Hasan Prishtina", Rr."Agim Ramadani", Rr. "Hasan Prishtina", Rr. "Adem Jashari", Rr. "Arsim Isufi", Rr. "Ramadan Kastrati", Rr. "Skenderbeu", Rr. "Besnik Maroca". | Rrjedhje në rrugë, (48), rrjedhje në pusetë të ujëmatësit (68), shkçyje nga rrjeti (9), verifikime (3) dhe zhvndosje të ujëmatësit (1), zhvendosje të kyçjes së ujëmatësve (3) pastrim të rrjetit (1). |
| **Viti** | 39 | Fshatrat: Trestenik, Pozharan, Sadovinë e Çerkezëve dhe Letnicë dhe në qytetin e Vitisë, Rr. "Elena Gjika", Rr. "Agim Ramadani", Rr. "Nikolla Teslla", "Rruga e Preshevës" dhe Rr. "Adem Jashari". | Rrjedhje në rrugë (19), defekte në puseta (5), defekte në rrjetin e ujësjellësit (12), defekte në pusetë të ujëmatësit (1) dhe verifikim i ujëmatësit (1). Në FPU Letnicë, në brendi të fabrikës është bërë rregullimi i valvulës në sentimentues (1). |
| **Totali:** | **590**[9] | | |

[9] Në këto shifra janë të përfshira vetëm defektet dhe jo ankesat, lajmërimet për ujëmatës jo funksional, verifikimet dhe kërkesat e ndryshme.

**Gjatë periudhës raportuese për TM3/2024, ndërprerje të ujit për shkak të defekteve në rrjetin e ujësjellësit ka pasur në lagjet/rrugët:**

Korrik 2024:

- Në rrugën "Shyt Mareci" është ndalur uji rreth katër orë për shkak të defektit në gypin kryesorë;
- Në rrugën "Mulla Idrizi" është ndalur uji rreth tre orë për shkak të defektit në gypin kryesor;
- Në rrugën "Xheladin Kurbaliu" është ndalur uji rreth katër orë për shkak të defektit në gypin kryesor;
- Në rrugën "Ali Hadri" është ndalur uji rreth dy orë për shkak të defektit në gypin kryesor;
- Në rrugën "Beqir Musliu" është ndalur uji rreth katër orë për shkak të defektit në gypin kryesor;
- Në rrugën "Shefik Miftari" është ndalur uji rreth tre orë për shkak të defektit në gypin kryesor;
- Në rrugët "Lotë Vaku", Idriz Seferi, Kodra e Dëshmorëve , fshati Velekincë dhe Livoç i Ulët është ndalur uji rreth tetë orë për mbushjen e rezervuarit në Kodrën e Dëshmorëve;
- Në fshatin "Kolloleq" është ndalur uji rreth një orë për shkak të defektit në gypin kryesor DN 63 mm PE;
- Në fshatin "Kolloleq" është ndalur uji rreth dy orë për shkak të defektit në gypin kryesor DN 90 mm PE;
- Në fshatin "Kopërnicë" është ndalur uji rreth një orë për shkak të defektit në gypin kryesor DN 6/4 mm PE;
- Në fshatin "Koretin" është ndalur uji rreth 6 orë për shkak të patrimit/dezinfektimit të rrjetit dhe rezervurit;
- Në Kamenicë "Rruga Skenderbeu" është ndalur uji rreth katër orë për shkak të defektit në gypin DN 125 mm AC;
- Rrjedhjet e tjera kanë qenë në diametër ½ , ¾ ose 1", janë evituar në presion ose për një kohë të vogël është ndalur uji.

Gusht 2024:

Në lagjen "Dardania I" është ndalur uji rreth tetë orë për shkak të defektit në gypin kryesor;

- Në lagjen "Dheu i Bardhë" është ndalur uji rreth tre orë për shkak të defektit në gypin kryesor;
- Në Rr. "Xheladin Kurbaliu" është ndalur uji rreth dy orë për shkak të defektit në gypin kryesor;
- Në Rr. "Mulla Idrizi" është ndalur uji rreth dy orë për shkak të defektit në gypin kryesor;
- Është ndalur uji rreth tetë orë në rrugët Rr. "Lotë Vaku", Rr. "Idriz Seferi", Rr. "Kodra e Dëshmorëve", fshati Velekincë dhe Livoç i Ulët, për mbushjen e rezervuarit në Kodrën e Dëshmorëve;
- Në fshatin Shipashnicë e Eperme është ndalur uji rreth tre orë për shkak të defektit në gypin kryesor DN 5/4 mm PE;
- Në Kamenicë Rr. "Skenderbeu" është ndalur uji rreth një orë për shkak të defektit në gypin DN 5/4 PE;
- Në fshatin "Shipashnicë e Epërme" është ndalur uji rreth tre orë për shkak të defektit në gypin kryesor DN 6/4 mm PE;
- Në Kamenicë "Rruga Skenderbeu" është ndalur uji rreth një orë e gjysëm për shkak të vendosjes së Valvules 6/4 në objektin banesor;

- Në fshatin "Shipashnicë e Epërme" është ndalur uji rreth 24 orë për shkak të defektit në gypin kryesor shpërndarës DN 160 mm PE;
- Në Kamenicë, Rr. "Adem Jashari" është ndalur uji rreth një orë për shkak të defektit në gypin DN 5/4 PE;
- Në fshatin Berivojcë është ndalur uji rreth dy orë për shkak të defektit në gypin kryesor DN 6/4 mm PE;
- Në Kamenicë, Rr. "Dëshmorët e Kombit" është ndalur uji rreth një orë për shkak të defektit në gypin DN 5/4 PE;
- Rrjedhjet e tjera kanë qenë në diametër "¾" ose 1", të cilat janë evituar në presion ose për një kohë të shkurtër është ndalur uji.

**Shtator 2024:**

- Në fshatin "Zhegër" është ndalur uji rreth dymbëdhjetë orë për shkak të defektit në gypin kryesor;
- Në lagjen "Dardania 1" është ndalur uji rreth katër orë për shkak të defektit në gypin kryesor;
- Në Rrugën "Mulla Idrizi" është ndalur uji për rreth tre orë për shkak të defektit në gypin kryesor;
- Në Rrugën "Arben Ramadani" është ndalur uji rreth dy orë për shkak të defektit në gypin kryesor;
- Në Rrugën "Vëllezërit Frashëri" është ndalur uji rreth dy orë për shkak të defektit në gypin kryesor;
- Në Kamenicë "Rruga Ajet Kosovica" është ndalur uji rreth dy orë për shkak të defektit në gypin DN 160 mm PE;
- Në Kamenicë "Rruga Musli Imeri" është ndalur uji rreth një orë e gjysëm për shkak të defektit në gypin DN 63 mm PE;
- Në Kamenicë "Rruga Kadri Zeka" është ndalur uji rreth dy orë për shkak të defektit në gypin DN 125 mm PE;
- Rrjedhjet e tjera kanë qenë në diametër ¾ ose 1", dhe janë evituar në presion ose per një kohë të shkurtër është ndalur uji;
- Ndërprerjet e ujit për shkak turbullines në FPU–Letnicë nga furnizohet qyteti i Vitisë, Ramnishta, Drobeshi dhe Gërmova në kohëzgjatje rreth 4 orë.

***Shënim:*** *Për shkak të natyrës së punës të evitimit të rrjedhjeve, shumica e defekteve janë evituar në shtypje pa e ndalur ujin fare, ku këto raste janë kur defektet janë në profil të gypit të vogël ose kur nuk është i dëmtuar gypi shumë.*

### 8.3.1. DMA – zonat

➢ Në zonën e shërbimit për regjionin e Gjilanit i kemi (6) gjashtë zona DMA:

1. Lagjen Dardania 1 dhe 2[10];
2. Livoç i Ulët;
3. Kufcë e Epërme;
4. Kmetovc dhe Verbicë e Kmetovcit;

[10] Përfshinë burimet 14 dhe 15 të paraqitura në tabelën 38.

5. Shillovë e Muhaxherëve[11] dhe

Zona më e madhe është ajo ku përfshihen Lagjet e Zabelit, Arbërisë, Velekinca dhe Bregu i Djegun[12].

***Tabela 38. Analiza, prodhimi, faturimi dhe UPF, gjatë periudhës së TM3/2024 në DMA zonat për regjionin e Gjilanit***

<table>
<tr><th></th><th>Burimi</th><th>Prodhimi (m³)</th><th>Faturimi për (m³)</th><th>UPF (%)</th></tr>
<tr><td>1.</td><td>Rr. "Lidhja e Prizrenit" *10</td><td>69,250</td><td rowspan="8">170587</td><td rowspan="8">38.8</td></tr>
<tr><td>2</td><td>Lagjja "Bregu i Djegun" (te ish kombinati i duhanit)</td><td>3,736</td></tr>
<tr><td>3.</td><td>Rr. "Hysen Tërpeza"</td><td>19,267</td></tr>
<tr><td>4.</td><td>Lipovicët</td><td>16,238</td></tr>
<tr><td>5.</td><td>Mbrapa shkollës në Velekincë DN 63</td><td>4,877</td></tr>
<tr><td>6.</td><td>Velekincë DN 90</td><td>58,180</td></tr>
<tr><td>7.</td><td>Rr. "Mulla Idrizi"</td><td>105,790</td></tr>
<tr><td>8.</td><td>Rr. "Esat Berisha"*10</td><td>1,350</td></tr>
<tr><td>9.</td><td>Shillova 1</td><td>1,674</td><td rowspan="2">2814</td><td rowspan="2">74.23</td></tr>
<tr><td>10.</td><td>Shillova 2</td><td>9,244</td></tr>
<tr><td>11.</td><td>Kmetovc</td><td>16,247</td><td>10118</td><td>37.7</td></tr>
<tr><td>12.</td><td>Kufcë e Epërme</td><td>11,435</td><td>3601</td><td>68.5</td></tr>
<tr><td>13.</td><td>Livoç i Ulët</td><td>35,180</td><td>10952</td><td>68.9</td></tr>
<tr><td>14.</td><td>Lagjja "Dardania 1" *10</td><td>73,230</td><td rowspan="2">76913</td><td rowspan="2">19.7</td></tr>
<tr><td>15.</td><td>Lagjja "Dardania 2" *10</td><td>22,610</td></tr>
<tr><td></td><td>Prodhimi total m3/vit:</td><td>448,308</td><td>274,985</td><td>38.7</td></tr>
</table>

- **Në zonën e shërbimit për regjionin e Kamenicës kemi një zonë DMA:**
  Berivojcë – Lagjja Iliria

- **Në zonën e shërbimit për regjionin e Vitisë i kemi dy zona DMA:**
  1. Pozhorani
  2. DMA Zonë mbrenda qytetit të Vitisë,

[11] Përfshinë burimet 9 dhe 10 të paraqitura në tabelën 38.

[12] Përfshijnë burimet nga 1 deri në 8 të paraqitura në tabelën 38.

## 8.4. Mirëmbajta e rrjetit të kanalizimit

Gjatë tremujorit të tretë të vitit 2024, në rrjetin e kanalizimit kanë qenë gjithsej: 670 intervenime duke përfshirë Njësitë Operative në Gjilan, Kamenicë dhe Viti.

***Tabela 39. Numri i intervenimeve në rrjetin e kanalizimit gjatë periudhës së TM3/2024***

| Njësia | Numri i intervenimeve | Përshkrimi |
|---|---|---|
| Gjilan | 586 | Debllokime kanalizimi dhe pastrimi i pusetave |
| Viti | 37 | Debllokime kanalizimi dhe pastrim i pusetave |
| Novobërdë | 5 | Debllokime kanalizimi dhe pastrimi pusetave |
| Partesh | 3 | Debllokime kanalizimi dhe pastrimi pusetave |
| Kamenicë | 32 | Debllokime kanalizimi dhe pastrimi pusetave |
| Ranilluk | 5 | Debllokime kanalizimi dhe pastrimi pusetave |
| Spitali/Burgu | 2 | Debllokime kanalizimi dhe pastrimi pusetave |
| **Total:** | **670** | |

***Tabela 40. Mirëmbajtja e rrjetit të kanalizimit gjatë periudhës së TM3/2024 në Gjilan***

| Muaji | Gjatësia e rrjetit të kanalizimit (km) |
|---|---|
| Korrik | 9.0 km |
| Gusht | 14.64 km |
| Shtator | 11.61 km |
| **TOTALI** | **35.25 km** |

# 9. DIVIZIONI PËR PLANIFIKIM DHE MENAXHIM TË PROJEKTEVE

## 9.1. Aktivitetet e realizuara

Gjatë tremujorit të tretë të vitit 2024, Divizioni për Planfikimin dhe Menaxhimin e Projekteve ka realizuar aktivitetet e paraqitura në tabelën më poshtë:

***Tabela 41. Aktivitetet e realizuara nga DPMP gjatë tremujorit të tretë të vitit 2024***

| | Aktivitet | Numri i aktiviteteve |
|---|---|---|
| 1. | Pëlqime në parim për banime kolektive dhe afarizëm | 19 |
| 2. | Pëlqim në parim për banim individual | 45 |
| 3. | Pëlqim në parim për institucione | 4 |
| 4. | Evidentimi i intervenimeve në GIS | 1000 |
| 5. | Insertimin e kërkesave të reja për kyçje në rrjetin e ujësjellësit | 83 |
| 6. | Vlerësim të ofertave në Prokurim | 9 |
| 7. | Menaxhim dhe mbikëqyerje të kontratave | 10 |

Përveç këtyre aktiviteteve të lartëpërmendura, zyrtarët nga divizioni i Planifikimit dhe Menaxhimit të Projekteve janë të angazhuar edhe në tri projekte të rëndësishme në zhvillimin e Ndërmarrjes siç janë:

1. FLOWS;
2. ITUN dhe
3. RIVLËRSIMI I ASETEVE.

Kryesuesja e Bordit të Drejtorëve

Gashi

---------------------------------------------

Znj. Filloretë Gashi Sadiku